



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 190

Tiranë – E martë, 1 shtator 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 27.8.2026	Për miratimin e rregullave, për zhvillimin e projekteve të infrastrukturës energetike rajonale dhe transevropiane..... 18781
Udhëzim i ministrit të Arsimit nr. 16, datë 27.8.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 14, datë 10.7.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar..... 18800
Urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 459, datë 28.8.2026	Për miratimin e masave për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar..... 18801
Urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 460, datë 28.8.2026	Për miratimin e metodës, për specifikimin e shpenzimeve, për përcaktimin dhe eliminimin e kërcënimit dhe të dëmit në mjedis..... 18805
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 3814, datë 8.7.2026	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Aleksandra Trola..... 18807
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 3815, datë 8.7.2026	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Mejtime Xhuveli..... 18807



VENDIM

Nr. 650, datë 27.8.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS ENERGJETIKE RAJONALE DHE TRANSEVROPIANE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 12, të nenit 4, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti, qëllimet dhe fushëveprimi

1. Ky vendim përcakton rregullat për zhvillimin në kohë dhe ndërveprueshmërinë e projekteve me interes për Komunitetin e Energjisë (PECI) dhe projekteve me interes të ndërsjellë (PMI), të cilat kontribuojnë në garantimin e zbutjes së ndryshimeve klimatike, në veçanti, në arritjen e objektivave të Komunitetit të Energjisë dhe të BE-së për energjinë, dhe klimën për vitin 2030 dhe të objektivit të neutralitetit klimatik jo më vonë se viti 2050, si dhe në garantimin e ndërlidhjes së sistemeve energjetike evropiane dhe rajonale, sigurisë energjetike, integritetit të tregut dhe të sistemit, konkurrencës që u sjell përfitime të gjitha palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe përbalueshmërisë së çmimeve të energjisë nga konsumatorët.

2. Në veçanti, ky vendim:

a) parashikon identifikimin e projekteve në listën e projekteve me interes për Komunitetin e Energjisë (PECI) dhe projekteve me interes të ndërsjellë (PMI), të përcaktuar sipas kreut II të këtij vendimi;

b) lehtëson zbatimin në kohë të projekteve të përfshira në listën e Komunitetit të Energjisë përmes thjeshtimit, bashkërendimit më të ngushtë dhe përsheptimit të procesit të dhënies së lejeve, si dhe nëpërmjet rritjes së transparencës e të pjesëmarrjes së publikut;

c) parashikon rregullat për ndarjen ndërkufitare të kostove dhe politikat nxitëse të lidhura me rrezikun për projektet në listën e Komunitetit të Energjisë;

ç) përcakton kushtet për kualifikimin e projekteve në listën e Komunitetit të Energjisë për ndihmë teknike dhe financiare nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet Instrumentit për Ndihmën e Paraanëtarësimit (IPA) dhe Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar (NDICI).

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të këtij vendimi, përveç përkufizimeve të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në aktet përkatëse të Komunitetit të Energjisë, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “**Infrastrukturë energjetike**”, çdo pajisje apo impiant fizik që bën pjesë në kategoritë e infrastrukturës energjetike, të përcaktuara në shtojcën II, bashkëlidhur vendimit, dhe që ndodhet brenda Komunitetit të Energjisë;

b) “**Ngushtim kapaciteti i infrastrukturës energjetike**”, kufizimi i rrjedhave fizike në një sistem energjetik për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme të transmetimit, që përfshin, ndër të tjera, mungesën e infrastrukturës;

c) “**Vendim gjithëpërfshirës**”, vendimi apo tërësia e vendimeve, që merren nga autoriteti apo autoritetet përgjegjëse shqiptare apo të një pale tjetër kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, që nuk përfshijnë gjykatat apo kolegjet

¹ Kjo rregullore është përafëruar plotësisht me rregulloren (BE) 2022/869 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 30 maj 2022, “Mbi udhëzimet për infrastrukturën energjetike transevropiane”, që ndryshon rregulloret (KE) nr. 715/2009, (BE) 2019/942 dhe (BE) 2019/943 dhe direktivat 2009/73/KE dhe (BE) 2019/944, si dhe shfuqizon rregulloren (BE) nr. 347/2013, numri

CELEX 02022R0869, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, 158, datë 3.6.2022, faqe 45, e inkorporuar dhe e përshtatur në Komunitetin e Energjisë me vendimin e Këshillit Ministror nr. 2023/02/MC-EnC, datë 14 dhjetor 2023, dhe e amenduar me vendimin nr. 2023/03/MC-EnC, datë 14 dhjetor 2023.



gjyqësore, që përcaktojnë nëse një promovues projekti autorizohet ose jo të ndërtojë infrastrukturën energjetike për të realizuar një projekt me interes për Komunitetin e Energjisë, duke pasur mundësinë të fillojë ose të prokurojë e të fillojë, punimet e nevojshme ndërtimore (faza gati për ndërtim), pa paragjykuar çdo vendim të marrë në kuadër të një procedure administrative në shkallë apeli;

c) **“Projekt”**, një ose disa rrjete, gazsjellës, impiante, pajisje apo instalime që bëjnë pjesë në kategoritë e infrastrukturës energjetike, të përcaktuara në shtojcën II, bashkëlidhur vendimit;

d) **“Projekt me interes për Komunitetin e Energjisë (PECI)”**, një projekt i nevojshëm për zbatimin e infrastrukturës energjetike dhe që përfshihet në listën e Komunitetit të Energjisë;

dh) **“Projekt me interes të ndërsjellë (PMI)”**, një projekt i promovuar nga Bashkimi Evropian në bashkëpunim me një ose më shumë vende të Komunitetit të Energjisë, në përputhje me letrat e mbështetjes nga qeveritë e vendeve të prekura drejtpërdrejt ose marrëveshje të tjera jodetyruese, i cili bie nën njërin nga kategoritë e infrastrukturës energjetike të përcaktuara në pikën 1, shkronjat “a” ose “dh”, në pikën 3, shkronja “a”, ose në pikën 5, shkronjat “a” ose “c”, të shtojcës II, bashkëlidhur vendimit, i cili kontribuon në objektivat e Bashkimit Evropian për energjinë dhe klimën për vitin 2030 dhe objektivin e tij për neutralitetin klimatik për vitin 2050 dhe që është në listën e Bashkimit Evropian;

e) **“Projekte konkurruese”**, projektet që plotësisht ose pjesërisht adresojnë të njëjtën mangësi të identifikuar infrastrukturore ose të njëjtën nevojë rajonale infrastrukturore;

ë) **“Promovues projekti”**, njëri prej subjekteve të mëposhtme:

i. Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) ose një operator apo investitor tjetër që zhvillon një projekt në listën e Komunitetit të Energjisë; ose

ii. Në rastin e më shumë se një OST-je, OSSH-je, operatori ose investitori të tillë, ose ndonjë grupi të tyre, subjekti me personalitet juridik, sipas ligjit të zbatueshëm vendor, i përcaktuar me marrëveshje kontraktuale ndërmjet tyre dhe që ka kapacitetin të marrë përsipër detyrime ligjore dhe të përballojë përgjegjësi financiare në emër të palëve në rregullimin kontraktual;

f) **“Rrjet inteligjent i energjisë elektrike”**, rrjeti elektrik, përfshirë rrjetet e shpërndarjes që operojnë në ishull, që nuk janë të ndërlidhur ose nuk janë të ndërlidhur mjaftueshëm me rrjetet energjetike të Komunitetit të Energjisë, që mundëson integrimin me kosto efikase dhe kontrollin aktiv të sjelljes e të veprimeve të të gjithë përdoruesve të lidhur në të, përfshirë gjeneruesit, konsumatorët dhe *prosumator*-ët, me qëllim garantimin e një sistemi energjetik ekonomikisht efikas e të qëndrueshëm, me humbje të vogla dhe nivel të lartë integrimi të burimeve të rinovueshme, sigurie furnizimi dhe sigurie, ku operatori i rrjetit mund të monitorojë në mënyrë digjitale veprimet e përdoruesve dhe që përdor teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit për komunikimin me operatorët, gjeneruesit, impiantet e depozitimit dhe konsumatorët apo *prosumator*-ët, e lidhur me qëllim transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike në një mënyrë të qëndrueshme, me kosto efektive dhe të sigurt;

g) **“Rrjet inteligjent i gazit”**, rrjet gazi që përdor zgjidhje inovative dhe digjitale për të integruar, në mënyrë efikase për koston, një shumëllojshmëri burimesh gazi me karbon të ulët dhe në veçanti të rinovueshëm, në përputhje me nevojat e konsumatorëve dhe kërkesat për cilësinë e gazit, me qëllim uljen e prezencës së karbonit lidhur me konsumin e gazit, mundësimin e një pjesëmarrjeje më të madhe të gazeve të rinovueshme dhe me karbon të ulët, si dhe krijimin e lidhjeve me bartës e sektorë të tjerë energjetikë, përfshirë përmirësimet fizike nëse janë të domosdoshme për funksionimin e pajisjeve e të instalimeve për integrimin e gazeve me karbon të ulët dhe veçanërisht të atyre të rinovueshme;

gj) **“Autoritet i përfshirë”**, autoritet që, sipas legjislacionit në fuqi, është kompetent për lëshimin e lejeve dhe autorizimeve të ndryshme që lidhen me planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e aseteve të paluajtshme, përfshirë infrastrukturën energjetike;

h) **“Autoritet rregullator kombëtar”**, Enti Rregullator i Energjisë (ERE), institucioni i pavarur, i krijuar, i organizuar dhe që funksionon në bazë të ligjeve nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar;

i) **“Autoritet rregullator kombëtar përkatës”**, autoritetet përkatëse rregullatore kombëtare në palët kontraktuese pritëse të projekteve dhe në palët



kontraktuese tek të cilat projekti ka ndikim pozitiv të konsiderueshëm;

j) **“Punime”**, blerja, furnizimi dhe dërgimi i pjesëve, sistemeve e shërbimeve, përfshirë programet kompjuterike, kryerja e aktiviteteve të zhvillimit, ripërdorimit, ndërtimit e instalimit që lidhen me një projekt, pranimit i instalimeve dhe nisja e projektit;

k) **“Studime”**, aktivitetet e nevojshme për përgatitjen e zbatimit të projektit, si studimet përgatitore, të fizibilitetit, të vlerësimit, të testimit dhe të vlefshmërisë, përfshirë programet kompjuterike, si dhe çdo masë tjetër e mbështetjes teknike, përfshirë veprimet paraprake për përcaktimin e zhvillimin e projektit dhe vendimmarrjen për financimin e tij, siç është zbulimi i vendndodhjeve/siteve përkatëse dhe përgatitja e paketës financiare;

l) **“Komisionim”**, procesi i vënies në operim të një projekti pasi ka përfunduar ndërtimi i tij;

ll) **“Asete të dedikuara për hidrogjen”**, infrastruktura e gatshme për të pranuar hidrogjen të pastër pa punime të mëtejshme përshtatjeje, përfshirë rrjetet e gazsjellësve ose impiantet e depozitimit, të ndërtuara rishtazi, të rikonvertuara nga asete të gazit natyror ose të dyja;

m) **“Konvertim (ripërdorim)”**, përmirësimi ose modifikimi teknik i infrastrukturës ekzistuese të gazit natyror, me qëllim që ajo të dedikohet për përdorimin e hidrogjenit të pastër;

n) **“Përshtatje ndaj klimës”**, procesi që garanton se qëndrueshmëria e infrastrukturës energjetike ndaj ndikimeve të mundshme negative të ndryshimeve klimatike arrihet nëpërmjet një vlerësimi të cenueshmërisë e të rrezikut klimatik, përfshirë masat përkatëse të përshtatjes;

nj) **“Sekretariati i Komitetit të Energjisë”**, sekretariati i ngritur sipas Traktatit të Krijimit të Komitetit të Energjisë;

o) **“Bordi Rregullator i Komitetit të Energjisë”**, institucioni koordinues i rregullatorëve kombëtarë të energjisë të palëve nënshkruese të Traktatit të Komitetit të Energjisë;

p) **“Këshilli Ministror”**, Këshilli Ministror i Komitetit të Energjisë;

q) **“Grupi”**, organi i ngritur sipas kreut IV dhe shtojcës III të këtij vendimi, që përgatit listat paraprake të projekteve;

r) **“Palët kontraktuese”**, palët nënshkruese të Traktatit të Krijimit të Komitetit të Energjisë;

rr) **“ENTSO-E”** Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike;

s) **“ENTSO-G”** Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Gazin;

sh) **“ECDSO-E”** Platforma Koordinuese për operatorët e sistemeve të shpërndarjes për energjinë elektrike e Komitetit të Energjisë.

KREU II

PROJEKTET ME INTERES PËR KOMUNITETIN E ENERGJISË (PECI) DHE PROJEKTET ME INTERES TË NDËRSJELLË (PMI)

Neni 3

Lista e projekteve me interes për Komitetin e Energjisë dhe projekteve me interes të ndërsjellë

1. Ministria përgjegjëse për energjinë, ERE, OST sh.a., dhe Albgaaz sh.a. përcaktojnë përfaqësuesit e tyre në dy grupet që do të krijohen sipas dispozitave të këtij neni dhe shtojcës III, të këtij vendimi. Anëtarësia e çdo grupi bazohet në secilin korridor e zonë prioritare dhe mbulimin e tyre gjeografik, siç përcaktohet në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Anëtarët e grupeve, që përfaqësojnë institucionet dhe shoqëritë energjetike shqiptare, do të jenë të angazhuar të japin kontributin e tyre në hartimin dhe miratimin e rregulloreve përkatëse të procedurës së çdo grupi, duke pasur parasysh dispozitat e shtojcës III, bashkëlidhur vendimit.

3. Përfaqësuesit e institucioneve dhe shoqërive shqiptare, që janë pjesë e organeve vendimmarrëse të secilit grup, do të marrin pjesë në miratimin e një liste paraprake të projekteve, të hartuar sipas procesit të përcaktuar në seksionin 2, të shtojcës III të vendimit dhe në përputhje me plotësimin e kriterëve të nenit 4 të këtij vendimi. Në përputhje me dispozitat e këtij vendimi, gjatë hartimit të listës paraprake:

a) çdo propozim individual për projekt, që do të përfshijë vendin tonë, do të kërkojë miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas dispozitave të këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi. Nëse nuk jep miratimin, ministria paraqet arsyet e argumentuara para grupit përkatës;

b) merret parasysh këshilla e Sekretariatit të Komitetit të Energjisë, me qëllim që numri i



përgjithshëm i projekteve në listën e Komunitetit të Energjisë të jetë i menaxhueshëm.

4. Kur një grup harton listën e tij paraprake:

a) çdo propozim individual për një projekt kërkon miratimin e palëve kontraktuese, territorit të të cilave i përket projekti. Nëse një palë kontraktuese nuk jep miratimin e saj, ajo duhet t'ia paraqesë grupit përkatës arsyet e saj të qenësishme për këtë mosmiratim;

b) ai duhet të marrë në konsideratë këshillat e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, me qëllim që të ketë një numër të përgjithshëm të menaxhueshëm projektesh në listën e Komunitetit të Energjisë.

5. Lista e projekteve me interes për Komunitetin e Energjisë (PECI) dhe e projekteve me interes të ndërsjellë (PMI) që prekin drejtpërdrejt një ose më shumë palë kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë miratohet nga Këshilli Ministror me vendim sipas titullit II të Traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë. Lista përcaktohet çdo dy vjet, mbi bazën e listave paraprake të miratuara nga organet vendimmarrëse të grupeve. Kur harton listën e Komunitetit të Energjisë duke ndërthurur listat paraprake, Këshilli Ministror:

a) siguron që të përfshihen vetëm projektet që plotësojnë kriteret e nenit 4 të këtij vendimi;

b) siguron koherencën ndërrajonale, duke marrë parasysh opinionin e Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë;

c) merr parasysh opinionet e palëve kontraktuese;

ç) synon të garantojë një numër të përgjithshëm të menaxhueshëm projektesh.

6. Projektet me interes të Komunitetit të Energjisë (PECI) dhe projektet me interes të ndërsjellë (PMI), që bien nën kategoritë e infrastrukturës energjetike, të përcaktuara në pikën 1, shkronjat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “dh”, të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi, duhet të paraqiten me qëllim që të bëhen pjesë integrale e planeve përkatëse rajonale të investimeve, sipas nenit 34 të rregullores (BE) 2019/943, siç është përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC dhe të planeve kombëtare dhjetëvjeçare të zhvillimit të rrjetit, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe planeve të tjera kombëtare të infrastrukturës, sipas rastit. Projekteve me interes të Komunitetit të Energjisë do t'u jepet prioriteti më i lartë i mundshëm brenda secilit prej

këtyre planeve. Kjo pikë nuk zbatohet për projektet konkurruese dhe projektet që nuk kanë arritur një shkallë të mjaftueshme pjekurie për të ofruar një analizë kosto-përfitim specifike për projektin, siç përmendet në seksionin 2, pika 1, shkronja “ç”, të shtojcës III, bashkëlidhur këtij vendimi.

7. Projektet me interes për Komunitetin e Energjisë (PECI) dhe projektet me interes të ndërsjellë (PMI), që bien në kategoritë e infrastrukturës energjetike, të përcaktuara në pikën 1, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “dh”, të shtojcës II, bashkëlidhur vendimit, dhe që janë projekte konkurruese ose projekte që nuk kanë arritur një shkallë të mjaftueshme pjekurie për të ofruar një analizë kosto-përfitim, specifike për projektin, siç përmendet në seksionin 2, pika 1, shkronja “ç”, të shtojcës III, bashkëlidhur këtij vendimi, mund të përfshihen në planet përkatëse rajonale të investimeve, planet kombëtare dhjetëvjeçare të zhvillimit të rrjetit dhe plane të tjera kombëtare të infrastrukturës, sipas rastit, si projekte në shqyrtim.

Neni 4

Kriteret për vlerësimin e projekteve

1. Një projekt me interes për Komunitetin e Energjisë duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme, të përgjithshme:

a) Projekti bën pjesë të paktën në një nga korridoret dhe fushat prioritare të ndërlidhjes së infrastrukturës energjetike, të përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Përfitimet e përgjithshme të mundshme të projektit, të vlerësuara sipas kriterëve specifike përkatëse, tejkalojnë kostot e tij, përfshirë në afatgjatë;

c) Projekti përmbush njërin nga kriteret e mëposhtme:

i. përfshin të paktën dy palë kontraktuese, drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet ndërlidhjes me një vend të tretë, duke kaluar kufirin e dy ose më shumë palëve kontraktuese; ose

ii. ndodhet në territorin e një pale kontraktuese, në tokë ose në det, përfshirë ishujt, dhe ka ndikim të konsiderueshëm ndërkufitar, sipas pikës 1, të shtojcës IV, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Kriteret specifike, që zbatohen për projektet me interes për Komunitetin e Energjisë sipas kategorive përkatëse të infrastrukturës energjetike, janë:



a) Për projektet e transmetimit, shpërndarjes dhe depozitimit të energjisë elektrike (kategoria 1, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “dh”, të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi): projekti kontribuon ndjeshëm në qëndrueshmëri nëpërmjet integritetit të energjisë së rinovueshme në rrjet, transmetimit ose shpërndarjes së gjenerimit të rinovueshëm drejt qendrave kryesore të konsumit dhe vendndodhjeve të depozitimit dhe uljes së kufizimit të energjisë, si dhe kontribuon të paktën në njërin prej kriterëve të mëposhtme:

i. integrimin e tregut, përfshirë heqjen e izolimit energjetik të të paktën një pale kontraktuese e uljen e ngushtimeve, konkurrencën, ndërveprueshmërinë dhe fleksibilitetin e sistemit; ose

ii. sigurinë e furnizimit, përfshirë ndërveprueshmërinë, fleksibilitetin e sistemit, sigurinë kibernetike, lidhjet e përshtatshme dhe operimin e sigurt e të besueshëm;

b) Për projektet e rrjeteve inteligjente të energjisë elektrike (kategoria 1, shkronja “e”, e shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi): projekti kontribuon ndjeshëm në qëndrueshmëri nëpërmjet integritetit të energjisë së rinovueshme dhe kontribuon të paktën në dy prej kriterëve të mëposhtme:

i. sigurinë e furnizimit;

ii. integrimin e tregut;

iii. sigurinë e rrjetit, fleksibilitetin dhe cilësinë e furnizimit; dhe

iv. integrimin inteligjent të sektorëve;

c) Për projektet e transportit dhe depozitimit të dioksidit të karbonit (kategoria 5, e shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi): projekti kontribuon ndjeshëm në qëndrueshmëri nëpërmjet uljes së emetimeve në instalimet industriale të lidhura dhe kontribuon në të gjitha kriteret e mëposhtme:

i. shmangien e emetimeve, duke ruajtur sigurinë e furnizimit;

ii. rritjen e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së transportit e depozitimit; dhe

iii. përdorimin efikas të burimeve;

ç) Për projektet e hidrogjenit (kategoria 3, e shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi): projekti kontribuon ndjeshëm në qëndrueshmëri, përfshirë uljen e emetimeve të gazeve serrë, duke zhvilluar hidrogjenin e rinovueshëm ose me karbon të ulët, dhe kontribuon të paktën në njërin prej kriterëve të mëposhtme:

i. integrimin e tregut;

ii. sigurinë e furnizimit e fleksibilitetin; ose

iii. konkurrencën;

d) Për elektrolizuesit (kategoria 4, e shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi): projekti kontribuon ndjeshëm në të gjitha kriteret e mëposhtme:

i. qëndrueshmërinë;

ii. sigurinë e furnizimit; dhe

iii. mundësimin e shërbimeve të fleksibilitetit nëpërmjet integritetit inteligjent të sektorit energjetik;

dh) Për projektet e rrjeteve inteligjente të gazit (kategoria 2, e shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi): projekti kontribuon ndjeshëm në qëndrueshmëri, nëpërmjet integritetit të një shumëllojshmërie gazesh me karbon të ulët dhe të rinovueshëm në sistemet e transmetimit, shpërndarjes ose depozitimit, dhe kontribuon të paktën në njërin prej kriterëve të mëposhtme:

i. sigurinë e rrjetit dhe cilësinë e furnizimit;

ii. funksionimin e tregut dhe shërbimet ndaj konsumatorit; ose

iii. lehtësimin e integritetit inteligjent të sektorit energjetik.

3. Për projektet, që bëjnë pjesë në kategoritë e shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi, kriteret specifike vlerësohen sipas treguesve të përcaktuar në pikat 2.1–2.6, të shtojcës IV, bashkëlidhur këtij vendimi. Secili grup vlerëson përfitimet e çdo projekti në mënyrë transparente e objektive dhe përcakton metodën e vet të vlerësimit mbi bazën e kontributit të grumbulluar ndaj kriterëve. Vlerësimi çon në një renditje projektesh vetëm për përdorim të brendshëm të grupit pasi në përputhje me këtë vendim, as lista paraprake dhe as lista e Komunitetit të Energjisë nuk përcaktojnë ndonjë renditje të projekteve të listuara.

Neni 5

Zbatimi dhe monitorimi i projekteve në listën e Komunitetit të Energjisë

1. Promovuesit e projekteve hartojnë një plan zbatimi për projektet në listën e Komunitetit të Energjisë, që përfshin një tabelë afatesh kohore për secilën prej fazave:

a) studimet e fizibilitetit e të projektimit, përfshirë përshtatjen ndaj klimës dhe përputhshmërinë me legjislacionin mjedisor dhe me parimin e “mosdëmtimit të konsiderueshëm”;

b) miratimin nga ERE ose nga çdo autoritet tjetër i përfshirë;

c) ndërtimin dhe komisionimin; dhe



ç) procesin e dhënies së lejeve.

2. OST-ja, OSSH-ja dhe AlbgaZ-i do të bashkëpunojnë me operatorët e tjerë në rajon për të lehtësuar zhvillimin e projekteve në listën e Komunitetit të Energjisë në zonën e tyre.

3. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë, i ndihmuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, dhe grupet përkatëse do të monitorojnë progresin e arritur në zbatimin e projekteve në listën e Komunitetit të Energjisë dhe, kur është e nevojshme, do të japin rekomandime për të lehtësuar zbatimin e tyre. Grupet mund të kërkojnë informacione shtesë në përputhje me pikat 4, 5 dhe 6, të këtij neni, të thërrasin takime me palët përkatëse dhe të ftojnë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë të verifikojë informacionin e dhënë në vend.

4. Deri më 31 dhjetor të çdo viti pas vitit të përfshirjes së një projekti në listën e Komunitetit të Energjisë, promovuesit e projekteve i dorëzojnë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë një raport vjetor për secilin projekt, që përmban hollësi mbi:

a) progresin e arritur në zhvillimin, ndërtimin e komisionimin, në veçanti lidhur me procesin e dhënies së lejeve, procedurën e konsultimit dhe përputhshmërinë mjedisore;

b) vonesat, nëse ka, në krahasim me planin e zbatimit, arsyet dhe vështirësitë e tjera; dhe

c) planin e rishikuar, nëse ka, për tejkalimin e vonesave.

5. Deri më 28 shkurt të çdo viti pasues, ministria i paraqet Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë, të asistuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, dhe grupit përkatës, raportin e plotësuar me informacion mbi progresin dhe vonesat në zbatimin e projekteve që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, referuar në pikën 4, të këtij neni, si dhe arsyet e vonesave. Kontributi i ministrisë shënohet qartë si i tillë dhe hartohet pa modifikuar tekstin e paraqitur nga promovuesit.

6. Deri më 30 prill të çdo viti, në të cilin miratohet një listë e re e Komunitetit të Energjisë, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë me ndihmën e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, duhet t'u paraqesë grupeve një raport të konsoliduar për projektet në listën e Komunitetit të Energjisë, që janë në kompetencën e autoriteteve rregullatore kombëtare, duke vlerësuar progresin e arritur dhe

ndryshimet e pritura në kostot e projektit, dhe, kur është e përshtatshme, të japë rekomandime se si të kapërcehen vonesat dhe vështirësitë e hasura.

Në raste të justifikuara siç duhet, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mund të kërkojë informacione shtesë të nevojshme për kryerjen e detyrave të saj të përcaktuara në këtë pikë.

7. Kur komisionimi i një projekti vonohet në krahasim me planin e zbatimit, për arsye të tjera përveç atyre që janë jashtë kontrollit të promovuesit, zbatohen masat e mëposhtme:

a) Nëse masat përkatëse rregullatore janë të zbatueshme sipas legjislacionit në fuqi, ERE siguron kryerjen e investimit;

b) Nëse kjo nuk është e mundur, promovuesi, brenda 24 muajve nga data e komisionimit të parashikuar, zgjedh një palë të tretë për financimin ose ndërtimin e krejt ose të një pjese të projektit;

c) Nëse nuk zgjidhet palë e tretë, ministria ose ERE, kur legjislacioni në fuqi e parashikon këtë, brenda dy muajve nga skadimi i afatit, cakton një palë të tretë të cilën promovuesi e pranon;

ç) Kur vonesa tejkalon 26 muaj, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në marrëveshje dhe bashkëpunim të plotë me ministrinë, mund të nisë një thirrje për propozime.

8. Një projekt mund të hiqet nga lista e Komunitetit të Energjisë, sipas procedurës së miratimit të listës së përcaktuar në nenin 3 të këtij vendimi, nëse përfshirja e tij është mbështetur në një informacion të pasaktë që ka qenë faktor përcaktues, ose nëse projekti nuk përputhet me legjislacionin e Komunitetit të Energjisë. Projektet, që nuk janë më në listë, humbasin të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me statusin PECE, me përjashtim të projekteve për të cilat dosja e aplikimit është pranuar për shqyrtim nga autoriteti kompetent, të cilat ruajnë të drejtat dhe detyrimet e kreut III, të këtij vendimi.

9. Projektet, që nuk janë më në listën e Komunitetit të Energjisë, humbasin të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me statusin e projektit me interes për Komunitetin e Energjisë, të parashikuar në këtë vendim. Megjithatë, një projekt, që nuk është më në listën e Komunitetit të Energjisë, por për të cilin një dosje aplikimi është pranuar për shqyrtim nga autoriteti kompetent, ruan të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi, përveç rasteve kur projekti është hequr nga lista e Komunitetit të Energjisë për arsye të përcaktuara në pikën 8, të këtij neni.



Neni 6

Koordinatorët e PEGI-t

1. Kur një projekt me interes për Komunitetin e Energjisë, i propozuar të zhvillohet në vendin tonë, has vështirësi të konsiderueshme zbatimi, ministria mund t'i kërkojë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, që, në bashkëpunim me Grupin e Përhershëm të Nivelit të Lartë, të caktojë një koordinator të PEGI-t për një periudhë deri në një vit, e cila mund të rinovohet dy herë.

2. Koordinatorin e PEGI-t:

a) promovon projektin për të cilin është caktuar dhe dialogun ndërkufitar ndërmjet promovuesve e palëve të interesuara;

b) ndihmon në konsultimin e palëve të interesuara, në diskutimin e rrugëve alternative dhe në marrjen e lejeve të nevojshme;

c) kur është e përshtatshme, këshillon promovuesit për financimin;

ç) siguron mbështetjen dhe drejtimin strategjik të palëve kontraktuese; dhe

d) dorëzon çdo vit dhe në përfundim të mandatit një raport te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mbi progresin dhe vështirësitë.

3. Koordinatorin e PEGI-t zgjidhet sipas një procesi të hapur, jodiskriminues dhe transparent dhe në bazë të përvojës së kandidatit në lidhje me detyrat specifike që i janë caktuar atij ose asaj për projektet përkatëse.

4. Vendimi që cakton koordinatorin e PEGI-t duhet të specifikojë termat e referencës, duke detajuar kohëzgjatjen e mandatit, detyrat specifike dhe afatet përkatëse, si dhe metodologjinë që duhet ndjekur. Përpjekja e koordinimit duhet të jetë në përpjesëtim me kompleksitetin dhe kostot e vlerësuara të projekteve.

5. Palët kontraktuese të përfshira duhet të bashkëpunojnë plotësisht me koordinatorin e PEGI-t në ekzekutimin e detyrave të përmendura në pikat 2 dhe 4, të këtij neni.

KREU III

DHËNIA E LEJEVE DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT

Neni 7

Statusi prioritar i projekteve në listën e Komunitetit të Energjisë

1. Miratimi i listës së Komunitetit të Energjisë përcakton, për qëllimet e çdo vendimi të nxjerrë në procesin e dhënies së lejeve, domosdoshmërinë e projekteve në listë nga këndvështrimi i politikës energjetike dhe klimatike, pa paragjykuar vendndodhjen e saktë, rrugën ose teknologjinë e projektit. Kjo pikë nuk zbatohet për projektet konkurruese ose për projektet që nuk kanë arritur një shkallë të mjaftueshme pjekurie për të ofruar një analizë specifike kosto-përfitim.

2. Me qëllim sigurimin e përpunimit efikas administrativ të dosjeve të aplikimit, që lidhen me projektet në listën e Komunitetit të Energjisë, promovuesit e projekteve dhe të gjitha autoritetet përkatëse sigurojnë që këto dosje të trajtohen në mënyrën më të shpejtë të mundshme, në përputhje me legjislacionin e Komunitetit të Energjisë dhe atë kombëtar.

3. Projektet në listën e Komunitetit të Energjisë marrin statusin e çështjes së rëndësisë kombëtare, sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe trajtohen si të tilla në proceset e dhënies së lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit, përfshirë proceset e vlerësimit mjedisor sipas legjislacionit mjedisor në fuqi.

4. Të gjitha procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, gjyqësore, ankimore e mjetet gjyqësore që lidhen me projektet në listë trajtohen si urgjente, sipas procedurave përkatëse ligjore që rregullojnë marrëdhëniet administrative dhe civile.

5. Ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkërendim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, vlerëson, duke pasur parasysh udhëzimet ekzistuese, cilat masa legjislative dhe jolegislative janë të nevojshme për thjeshtimin e procedurave të vlerësimit mjedisor.

6. Ministria përgjegjëse për energjinë informon Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për masat e identifikuara sipas pikës 5, të këtij neni.

7. Masat jolegislative dhe legjislative të identifikuara zbatohen brenda afateve të përcaktuara nga Komuniteti i Energjisë, pa paragjykuar



detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni i Komunitetit të Energjisë.

8. Projektet në listën e Komunitetit të Energjisë konsiderohen si me interes publik nga perspektiva e politikës së energjisë dhe mund të konsiderohen si projekte të një interesi publik mbizotërues. Kjo pikë nuk do të zbatohet për projektet konkurruese ose për projektet që nuk kanë arritur një shkallë të mjaftueshme pjekurie për të ofruar një analizë kosto-përfitim, specifike të projektit, siç përmendet në seksionin 2, pika 1, shkronja “ç”, të shtojcës III, bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 8

Organizimi i procesit të dhënies së lejeve

1. Autoriteti kompetent kombëtar për lehtësimin dhe bashkërendimin e procesit të dhënies së lejeve për projektet në listën e Komunitetit të Energjisë është ministria përgjegjëse për energjinë, siç përcaktohet në pikën 4, të nenit 5, të ligjit nr. 102/2015, dhe në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 59/2026.

2. Ministri përgjegjës për energjinë mund t’ia delegojë këto kompetenca një institucioni në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë për një projekt ose për një kategori projektesh, për aq sa ajo e gjykon se ky institucion ka kapacitetet dhe mundësinë për përmbushjen e këtyre kompetencave me kusht që:

a) ministria të njoftojë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për delegimin dhe informacioni lidhur me këtë delegim të publikohet në faqen zyrtare të internetit nga ministria ose nga promovuesi i projektit; dhe

b) vetëm një autoritet do të vijojë të jetë përgjegjës për projektin dhe të jetë pika e vetme e kontaktit për promovuesin e projektit, i cili do të koordinojë paraqitjen e të gjitha dokumenteve përkatëse në procesin që çon te vendimi gjithëpërfshirës.

Ministria mund të mbajë përgjegjësinë për të vendosur afate kohore, pa cenuar afatet kohore të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 10, të këtij vendimi.

3. Ministria përgjegjëse për energjinë ose institucioni, të cilit i janë deleguar kompetencat sipas pikës 2 të këtij neni, lehtëson lëshimin e vendimit gjithëpërfshirës, i cili nxirret brenda afateve të pikës 1 e nenit 10, të këtij vendimi, mbështetur në skemën

bashkëpunuese sipas njërës prej skemave të mëposhtme:

a) Skema e integruar: vendimi gjithëpërfshirës nxirret nga autoriteti kompetent kombëtar dhe është vendimi i vetëm ligjërishit i detyrueshëm; Autoritetet e tjera të përfshira mund të japin opinionin e tyre si *in-put*, i cili merret parasysht;

b) Skema e bashkërenduar: vendimi gjithëpërfshirës përbëhet nga disa vendime individuale, ligjërishit të detyrueshme, të nxjerra nga disa autoritete të përfshira, të cilat bashkërendohen nga autoriteti kompetent kombëtar. Ky i fundit mund të ngrejë një grup pune, të caktojë afate të arsyeshme rast pas rasti dhe, kur një vendim individual nuk lëshohet brenda afatit e vonesa nuk arsyetohet mjaftueshëm, mund të marrë vendim në emër të autoritetit tjetër ose ta konsiderojë miratimin/refuzimin si të dhënë, sipas legjislacionit vendas;

c) Skema bashkëpunuese: vendimi gjithëpërfshirës bashkërendohet nga autoriteti kompetent kombëtar, i cili cakton afate të arsyeshme rast pas rasti dhe monitoron respektimin e tyre nga autoritetet e përfshira.

4. Autoriteti kompetent kombëtar zgjedh ndërmjet tri skemave dhe zbaton atë që është më efektive në përputhje me legjislacionin që përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë administrative të institucioneve të përfshira në dhënien e miratimeve për projektet energjetike. Kur zgjidhet skema bashkëpunuese, njoftohet Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për arsyet. Skemat mund të zbatohen për projekte që mund të zhvillohen në tokë dhe/ose në det.

5. Kur një projekt kërkon vendime në dy ose më shumë palë kontraktuese, autoriteti kompetent kombëtar ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për bashkëpunim efikas me autoritetin ose autoritetet kompetente kombëtare të palëve të tjera kontraktuese, duke synuar hartimin dhe zbatimin e procedurave të përbashkëta, në veçanti lidhur me vlerësimin e ndikimeve mjedisore të projektit të promovuar.

6. Autoritetet kombëtare kompetente përkatëse të palëve kontraktuese të përfshira në një projekt të listës së Komunitetit të Energjisë, që i përket njërit prej korridoreve prioritare të rrjeteve energjetike në det, të përcaktuara në pikën 2, të shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi, caktojnë bashkërisht, ndërmjet tyre, një pikë të vetme kontakti për



promovuesit e secilit projekt. Kjo pikë kontakti është përgjegjëse për lehtësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve kombëtare kompetente lidhur me procesin e dhënies së lejeve për projektin, me qëllim lehtësimin e këtij procesi, si edhe të nxjerrjes së vendimeve nga autoritetet kombëtare kompetente përkatëse. Pikat e vetme të kontaktit mund të shërbejnë edhe si qendra për grumbullimin e dokumenteve ekzistuese që lidhen me projektet.

Neni 9

Transparenca dhe pjesëmarrja e publikut

1. Autoriteti kompetent kombëtar, në bashkëpunim me autoritetet e tjera të përfshira, publikon dhe përditëson një manual procedurash për procesin e dhënies së lejeve të zbatueshme për projektet në listën e Komunitetit të Energjisë, i cili përmban të paktën informacionin e specifikuar në pikën 1, të shtojcës VI, bashkëlidhur këtij vendimi. Manuali nuk është ligjërishit i detyrueshëm, por do të përmbajë ose do të citojë referenca të dispozitave ligjore përkatëse. Autoriteti kompetent kombëtar, kur është e nevojshme, do të bashkëpunojë dhe do të gjejë sinergji me autoritetet e vendeve fqinje me qëllim shkëmbimin e praktikave të mira dhe lehtësimin e procesit të dhënies së lejeve, në veçanti për zhvillimin e manualit të procedurave.

2. Pa paragjykuar legjislacionin mjedisor dhe kërkesat sipas konventave së Aarhusit dhe të Espoo-s, të gjitha palët e përfshira në procesin e dhënies së lejeve për një projekt të përfshirë në listën e Komunitetit të Energjisë ndjekin parimet për pjesëmarrjen e publikut, të përcaktuara në pikën 3, të shtojcës VI, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Brenda një periudhe indikative tremujore nga fillimi i procesit të dhënies së lejeve, promovuesi i projektit harton dhe dorëzon tek autoriteti kompetent kombëtar një koncept për konsultimin dhe pjesëmarrjen e publikut, bazuar në kërkesat dhe procedurat e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, duke respektuar manualin e parashikuar në pikën 1, të këtij neni. Autoriteti kompetent kombëtar kërkon modifikime ose miraton konceptin brenda tre muajve nga marrja e konceptit për konsultim me publikun.

4. Në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi, promovuesi i projektit ose, kur kjo kërkohej specifikisht nga legjislacioni, autoriteti

kompetent kombëtar, kryen të paktën një konsultim me publikun para dorëzimit të dosjes përfundimtare e të plotë të aplikimit. Promovuesi i projektit publikon në faqen e internetit të projektit një raport që shpjegon si janë marrë parasysh opinionet e shprehura në konsultime, duke treguar ndryshimet e bëra ose arsyet e mospranimit, dhe përgatit një raport përmbledhës të aktiviteteve të pjesëmarrjes publike, të cilin e dorëzon bashkë me dosjen e aplikimit.

5. Për projektet ndërkuftare, që përfshijnë dy ose më shumë palë kontraktuese, konsultimet publike sipas pikës 4 zhvillohen brenda një periudhe jo më shumë se dy muaj nga data e fillimit të konsultimit të parë.

6. Për projektet, që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm ndërkuftar në një ose më shumë shtete fqinje, për të cilat zbatohet Konventa Espoo, informacioni përkatës duhet t’u vihet në dispozicion autoriteteve kompetente kombëtare të shteteve fqinje përkatëse. Autoritetet kompetente kombëtare të shteteve fqinje përkatëse në procesin e njoftimit mund të sugjerojnë, kur është e përshtatshme, nëse ato ose ndonjë autoritet tjetër i interesuar dëshiron të marrë pjesë në procedurat përkatëse të konsultimit me publikun.

7. Promovuesi i projektit krijon dhe përditëson rregullisht një faqe interneti të dedikuar, të ndërlidhur me faqen e internetit të Komunitetit të Energjisë dhe platformën e transparencës, që plotëson kërkesat e pikës 6, të shtojcës VI, bashkëlidhur këtij vendimi. Promovuesi i projektit mund të mbajë konfidenciale informacionet e ndjeshme komerciale. Promovuesit e projektit duhet të publikojnë gjithashtu informacionin përkatës me anë të mjeteve të tjera të përshtatshme të informacionit, të hapura për publikun.

Neni 10

Kohëzgjatja dhe zbatimi i procesit të dhënies së lejeve

1. Procesi i dhënies së lejeve përbëhet nga dy procedura:

a) procedura para aplikimit, që mbulon periudhën ndërmjet fillimit të procesit dhe pranimit të dosjes së aplikimit nga autoriteti kompetent kombëtar, e cila zhvillohet brenda një periudhe indikative prej 24 muajsh; dhe



b) procedura ligjore e dhënies së lejeve, që mbulon periudhën nga data e pranimit të dosjes deri tek marrja e vendimit gjithëpërfshirës, e cila nuk tejkalon 18 muaj. Kur është e mundur, autoriteti kompetent kombëtar mund të parashikojë një procedurë ligjore më të shkurtër se 18 muaj.

2. Autoriteti kompetent kombëtar siguron që kohëzgjatja e kombinuar e të dyja procedurave të mos tejkalojë 42 muaj. Kur ai çmon se një ose të dyja procedurat nuk do të përfundojnë brenda afateve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, mund t'i zgjasë ato para skadimit, rast pas rasti, por jo më shumë se nëntë muaj, përveç rrethanave të jashtëzakonshme. Në rast të zgjatjes së afateve sipas kësaj pike, autoriteti kompetent kombëtar njofton grupin përkatës për zgjatjen.

3. Për të përcaktuar fillimin e procesit, promovuesit e projekteve njoftojnë me shkrim autoritetin kompetent kombëtar dhe përfshijnë një përshkrim mjaftueshëm të hollësishëm të projektit. Brenda tre muajve nga marrja e njoftimit, autoriteti kompetent kombëtar e njeh njoftimin ose, nëse çmon se projekti nuk është mjaftueshëm i pjekur, e refuzon me shkrim duke dhënë arsyet. Data e nënshkrimit të njohjes nga autoriteti kompetent kombëtar shënon fillimin e procesit të dhënies së lejeve. Kur përfshihen dy ose më shumë palë kontraktuese, si fillim i procesit shënohet data e pranimit të njoftimit të fundit nga autoriteti kombëtar përkatës.

4. Autoriteti kompetent kombëtar merr në konsideratë çdo studim të vlefshëm dhe leje ose autorizim të lëshuar për projektin para hyrjes në procesin e dhënies së lejeve dhe nuk kërkon dublikim të studimeve, lejeve apo autorizimeve.

5. Në palët kontraktuese, ku përcaktimi i një traseje ose vendndodhjeje, i kryer vetëm për qëllimet specifike të një projekti të planifikuar, duke përfshirë planifikimin e korridoreve të posaçme për infrastrukturën e rrjetit, nuk mund të përfshihet në procesin që çon në marrjen e vendimit gjithëpërfshirës, vendimi përkatës merret brenda një periudhe të veçantë gjashtëmuajore, e cila fillon në datën e paraqitjes nga promotori të dokumenteve përfundimtare dhe të plota të aplikimit.

Në rrethanat e përshkruara në paragrafin e parë të kësaj pike, zgjatja e afatit, e përmendur në pikën 2 të këtij neni, kufizohet në gjashtë muaj, përveçse në rrethanat të jashtëzakonshme, duke përfshirë edhe procedurën e përmendur në këtë paragraf.

6. Procedura para aplikimit përfshin hapat e mëposhtëm:

a) Jo më vonë se 6 muaj nga njoftimi, autoriteti kompetent kombëtar përcakton, mbi bazën e listës kontrolluese të pikës 1, shkronja “e”, të shtojcës VI, bashkëlidhur këtij vendimi, shtrirjen e raporteve e të dokumenteve dhe nivelin e detajimit që duhet të dorëzohet;

b) Harton, në bashkëpunim të ngushtë me promovuesin, një skemë të hollësishme afatesh; dhe

c) Me marrjen e projektdosjes, kërkon informacionin që mungon. Procedura para aplikimit përfshin, sipas rastit, përgatitjen e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, dokumentacionit të përshtatjes ndaj klimës, vlerësimit të ndikimeve mbi biodiversitetin dhe vlerësimit të përshtatshëm për ndikimet mbi zonat e mbrojtura, zonat candidate Emerald, zonat e propozuara ose të përcaktuara Natura 2000, habitatet natyrore, speciet e mbrojtura dhe korridoret ekologjike, përfshirë ndikimet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe kumulative.

7. Promovuesi i projektit siguron që dosja e aplikimit të jetë e plotë dhe e përshtatshme dhe kërkon mendimin e autoritetit kombëtar kompetent për këtë çështje sa më herët që të jetë e mundur gjatë procesit të dhënies së lejeve. Promovuesi i projektit bashkëpunon plotësisht me autoritetin kombëtar kompetent për të respektuar afatet e përcaktuara në këtë vendim.

8. Palët kontraktuese të sigurojnë që çdo ndryshim në legjislacionin kombëtar të mos çojë në zgjatjen e proceseve të dhënies së lejeve të filluara përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve. Për të ruajtur një proces të përsheptuar të dhënies së lejeve për projektet në listën e Komunitetit të Energjisë, autoritetet kombëtare kompetente përshtatin në mënyrën e duhur grafikun e përcaktuar në përputhje me shkronjën “b”, të pikës 6, të këtij neni, për të siguruar, për aq sa është e mundur, që afatet për procesin e dhënies së lejeve të përcaktuara në këtë nen të mos tejkalohen.

9. Afatet e këtij neni nuk paragjykojnë detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni i Komunitetit të Energjisë dhe ai ndërkombëtar, si dhe procedurat e ankimimit administrativ dhe të mjeteve gjyqësore para një gjykate kompetente. Afatet e përcaktuara në këtë nen për secilën prej procedurave të dhënies së lejeve nuk cenojnë afatet më të shkurtra, të përcaktuara nga palët kontraktuese.



KREU IV PLANIFIKIMI NDËRSEKTORIAL I INFRASTRUKTURËS

Neni 11

Analiza e kostos dhe përfitimit në nivelin e të gjithë sistemit energjetik

1. Për projektet, që bëjnë pjesë në kategoritë 1, shkronjat “a”, “b”, “ç” e “dh”, dhe kategorinë 3, të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi, zbatohen metodologjitë individuale të sektorit, të publikuara nga Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për energjinë elektrike (ENTSO-E) dhe për gazin natyror (ENTSOG).

2. Për projektet, që bëjnë pjesë në kategoritë 1, shkronjat “c” e “e”, si dhe në kategoritë 2, 4 dhe 5, të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi, zbatohen metodologjitë për një analizë të harmonizuar kosto-përfitim në nivel sistemi energjetik, që është hartuar nga Komisioni Evropian.

3. Çdo tre vjet, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë përcakton dhe publikon një grup treguesish dhe vlerash referuese përkatëse për krahasimin e kostove njësi të investimit për projekte të krahasueshme. Promovuesit e projekteve do të përdorin si vlera reference për analizat e kosto-përfitimit të projekteve treguesit e parë të publikuar nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë gjatë vitit 2025.

Neni 12

Skenarët për planet dhjetëvjeçare të zhvillimit të rrjetit

Për vlerësimin e projekteve të listës së Komunitetit të Energjisë do të merren në konsideratë skenarët e përbashkët, të përgatitur nga ENTSO-E dhe ENTSOG për planet dhjetëvjeçare të zhvillimit të rrjetit.

KREU V RRJETET NË DET TË HAPUR PËR INTEGRIMIN E ENERGJISË SË RINOVUESHME

Neni 13

Planifikimi i rrjetit në hapësirën detare

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me mbështetjen e Sekretariatit të Komunitetit të

Energjisë, lidh marrëveshje jodetyruese për bashkëpunim mbi objektivat për gjenerimin e energjisë së rinovueshme në det të hapur, që do të zhvillohet deri në vitin 2050 brenda çdo pellgu deti të përcaktuar në seksionin 2, të shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi, me hapa të ndërmjetëm në vitet 2030 dhe 2040, në përputhje me Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës dhe me potencialin e rinovueshëm në det të hapur të pellgut përkatës. Marrëveshja jodetyruese bëhet me shkrim dhe, në asnjë rast, nuk paragjykon të drejtën e qeverisë shqiptare për të zhvilluar projekte në hapësirën e ujërave territoriale dhe në zonën ekonomike ekskluzive detare.

2. Me synim zhvillimin e projekteve të rrjeteve energjetike në det të hapur, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë mund t'u drejtohet, sipas rastit, shteteve anëtare përkatëse të Bashkimit Evropian në ato pellgje deti, për të propozuar lidhjen e memorandumëve jodetyruese të mirëkuptimit për bashkëpunim mbi objektivat e gjenerimit të rinovueshëm në det të hapur dhe mund të bashkëpunojë me ENTSO-E me qëllim përfshirjen në procesin e planifikimit të rrjeteve në det të hapur brenda pellgjeve përkatëse.

KREU VI KUADRI RREGULLATOR

Neni 14

Mundësimi i investimeve me ndikim ndërkufitar

1. Kostot e investimeve të bëra në mënyrë efikase, të cilat përjashtojnë kostot e mirëmbajtjes, të lidhura me një projekt me interes për Komunitetin e Energjisë që bën pjesë në kategoritë 1, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” e “dh”, dhe në kategorinë 3, të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi, kur ato bëjnë pjesë në kompetencën e autoriteteve rregullatore kombëtare, përballohen nga operatorët përkatës të sistemit të transmetimit (OST) ose nga promovuesit e projekteve të infrastrukturës së transmetimit të palëve kontraktuese tek të cilat projekti ofron ndikim neto-pozitiv dhe në masën që nuk mbulohen nga pagesat e kongjestionit apo tarifa të tjera, paguhen nga përdoruesit e rrjetit nëpërmjet tarifave për akses në rrjetin e transmetimit të një apo disa palëve kontraktuese.



2. Dispozitat e këtij kreu zbatohen për një projekt me interes për Komunitetin e Energjisë kur të paktën një promovues kërkon nga autoritetet përkatëse zbatimin e tyre për kostot e projektit. Kur një projekt ka disa promovues, ERE, në bashkëpunim me autoritetet rregullatore kombëtare të palëve të tjera kontraktuese, u kërkon pa vonesë të gjithë promovuesve ta dorëzojnë kërkesën për investime bashkërisht, sipas pikës 4, të këtij neni.

3. Për një projekt me interes për Komunitetin e Energjisë, për të cilin zbatohet pika 1, e këtij neni, promovuesit e projektit duhet t'i mbajnë të gjitha autoritetet rregullatore kombëtare përkatëse të informuara rregullisht, të paktën një herë në vit dhe derisa projekti të komisionohet, për progresin e atij projekti dhe identifikimin e kostove dhe ndikimit të tij.

4. Sapo një projekt i tillë arrin pjekurinë e mjaftueshme dhe pritët të jetë gati për të nisur fazën e ndërtimit, brenda 36 muajve të ardhshëm, promovuesit, pas konsultimit me OST-të e palëve kontraktuese, që marrin ndikim neto-pozitiv të konsiderueshëm, dorëzojnë një kërkesë për investime. Kërkesa përfshin një kërkesë për ndarjen ndërkufitare të kostove dhe i dorëzohet të gjitha autoriteteve rregullatore kombëtare përkatëse, e shoqëruar nga:

a) një analizë kosto-përfitim, specifike për projektin, e përditësuar dhe në përputhje me metodologjinë e përmendur në kreun IV, të këtij vendimi;

b) një plan biznesi që vlerëson rentabilitetin financiar, përfshirë zgjidhjen financiare të zgjedhur dhe, për projektet e hidrogjenit, rezultatet e testimit të tregut; dhe

c) kur promovuesit bien dakord, një propozim të argumentuar për ndarjen ndërkufitare të kostove.

5. Brenda gjashtë muajve nga data në të cilën kërkesa për investime pranohet nga autoriteti i fundit rregullator kombëtar përkatës, ato autoritete, pas konsultimit me promovuesit, marrin vendime të koordinuara për ndarjen e kostove të investimit që përballon secili operator sistemi, si dhe përfshirjen e tyre në tarifa, ose për refuzimin e plotë a të pjesshëm të kërkesës nëse analiza e përbashkët konkludon se projekti ose një pjesë e tij nuk ofron përfitim neto të konsiderueshëm. Në ndarjen e kostove merren parasysh të ardhurat nga pagesat e kongestionit apo tarifa të tjera dhe të ardhurat nga mekanizmi i

kompensimit ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit.

6. Autoritetet rregullatore kombëtare përkatëse i njoftojnë vendimin e ndarjes së kostove Bordit Rregullator dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, të shoqëruar me arsyet e hollësishme, përfshirë:

a) vlerësimin e ndikimit të identifikuar mbi secilën palë kontraktuese, përfshirë tarifat;

b) vlerësimin e planit të biznesit;

c) aspektet e jashtme pozitive rajonale ose në nivel të Komunitetit të Energjisë; dhe

ç) rezultatin e konsultimit të promovuesve. Vendimi i ndarjes së kostove publikohet.

7. Kur ERE dhe autoritetet rregullatore kombëtare të palëve të tjera kontraktuese nuk arrijnë një marrëveshje lidhur me kërkesën për investime brenda gjashtë muajve, informojnë pa vonesë Bordin Rregullator dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Në këtë rast ose me kërkesë të përbashkët të tyre, vendimi për investimin, përfshirë ndarjen ndërkufitare të kostove, merret nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë brenda tre muajve nga data e referimit, afat i cili mund të zgjatet me dy muaj kur kërkohet informacion i mëtejshëm. Në vendimin e tij për kërkesën për investim, përfshirë ndarjen ndërkufitare të kostove, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do t'ua lejë autoriteteve rregullatore përkatëse përcaktimin e mënyrës se si kostot e investimit do të përfshihen në tarifat, në përputhje me ndarjen ndërkufitare të kostove, të përmendur më sipër. Vendimi i Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë publikohet.

8. Një kopje e të gjitha vendimeve për ndarjen e kostove, së bashku me të gjithë informacionin përkatës, në lidhje me secilin vendim, i njoftohet pa vonesë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë nga Bordi Rregullator i Komunitetit të energjisë. Ky informacion mund të dorëzohet në formë të përmbledhur. Sekretariati ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar.

9. Vendimet për ndarjen e kostove nuk duhet të ndikojnë në të drejtën e OST-së për të aplikuar dhe të ERE-s për të miratuar tarifat për aksesin në rrjetin e transmetimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. Ky nen nuk zbatohet për projektet me interes për Komunitetin e Energjisë që kanë marrë përjashtim nga:



a) nenet 32, 33 dhe 34 dhe neni 41(6), (8) dhe (10) i direktivës 2009/73/KE, i përshtatur dhe miratuar me vendimin 2011/02/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, në përputhje me nenin 36 të asaj Direktive;

b) neni 19(2) dhe (3) i rregullores (BE) 2019/943, i përshtatur dhe miratuar me vendimin 2011/02/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë ose neni 6, neni 59(7) dhe neni 60(1) i direktivës (BE) 2019/944, i përshtatur dhe miratuar me vendimin 2021/13/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, në përputhje me nenin 63 të rregullores (BE) 2019/943, i përshtatur dhe miratuar me vendimin 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë;

c) rregullat e ndarjes ose të aksesit të palëve të treta, në përputhje me nenin 17 të rregullores (KE) nr. 714/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të përshtatur dhe miratuar me vendimin 2011/02/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, ose me nenin 64 të rregullores (BE) 2019/943, i përshtatur dhe miratuar me vendimin 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, dhe nenin 66 të direktivës (BE) 2019/944, i përshtatur dhe miratuar me vendimin 2021/13/MC-EnC.

Neni 15

Politikat nxitëse rregullatore

1. Kur një promovues projekti mbart rreziqe më të mëdha për zhvillimin, ndërtimin, operimin ose mirëmbajtjen e një projekti me interes për Komunitetin e Energjisë, që bie në kompetencën e autoriteteve rregullatore kombëtare, në krahasim me rreziqet që normalisht mbarten nga një projekt i krahasueshëm, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) mund të ofrojë politika të përshtatshme nxitëse, në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit të energjisë dhe të Komunitetit të Energjisë.

2. Në rastin e një vendimi për politika nxitëse, ERE merr parasysh rezultatet e analizës kosto-përfitim dhe në veçanti aspektet e jashtme pozitive rajonale ose në nivel të Komunitetit të Energjisë dhe analizon rreziqet specifike të mbartura nga promovuesit, masat e zbutjes së rrezikut dhe arsyet e profilit të rrezikut. Rreziqet e kualifikueshme përfshijnë, në veçanti, rreziqet e lidhura me teknologjitë e reja të transmetimit, në tokë dhe në

det, rreziqet e mosmbulimit të kostove dhe rreziqet e zhvillimit.

3. Vendimi për politika nxitëse merr parasysh natyrën specifike të rrezikut dhe mund të mbulojë, ndër të tjera, një ose disa nga masat:

a) rregullat për investimin paraprak;

b) rregullat për njohjen e kostove të bëra në mënyrë efektive para komisionimit;

c) rregullat për një kthim shtesë të kapitalit të investuar; ose

ç) çdo masë tjetër që konsiderohet e nevojshme dhe e përshtatshme. Enti Rregullator i Energjisë miraton dhe publikon metodologjinë e kriteret që përdoren në vlerësimin e investimeve dhe të rreziqeve më të mëdha të mbartura nga projektet.

4. ERE do t'i paraqesë Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i këtij vendimi, metodologjinë e tij dhe kriteret e përdorura për të vlerësuar investimet në projektet e infrastrukturës energjetike dhe rreziqet më të larta të shkaktuara nga këto projekte, të përditësuara në përputhje me zhvillimet më të fundit legjislative, politike, teknologjike dhe të tregut. Kjo metodologji dhe këto kriteret duhet, gjithashtu, të adresojnë shprehimisht rreziqet specifike që mbartin rrjetet në det të hapur për energjinë e rinovueshme, të përmendura në pikën 1, shkronja “dh”, të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe projektet, të cilat, ndërsa kanë shpenzime të ulëta kapitale, kanë shpenzime të konsiderueshme operative.

KREU VII FINANCIMI

Neni 16

Përshtatshmëria e projekteve për mbështetje financiare nga BE-ja

1. Projektet me interes për Komunitetin e Energjisë, që bëjnë pjesë në kategoritë e infrastrukturës energjetike të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi, kualifikohen për ndihmë teknike dhe financiare të Bashkimit Evropian për përgatitjen dhe zbatimin e projektit, nga Instrumenti për Ndihmën e Paraanëtarësimit (IPA) dhe Instrumenti i Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar (NDICI), përfshirë Kuadrin e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF), Platformën e Investimeve në Fqinjësi



(NIP), Fondin Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm (EFSD) dhe Fondin Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm + (EFSD+).

2. Projektet me interes për Komunitetin e Energjisë kualifikohen për ndihmë financiare të Bashkimit Evropian në formën e granteve, garancive ose instrumenteve të tjera financiare nga instrumentet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, kur plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:

a) Analiza kosto-përfitim, specifike për projektin, ofron prova për ekzistencën e aspekteve të jashtme pozitive të konsiderueshme, si siguria e furnizimit, fleksibiliteti i sistemit, solidariteti ose inovacioni;

b) Projekti ka marrë një vendim për ndarjen ndërkufitare të kostove ose, për projektet e hidrogjenit, që nuk bien në kompetencën e autoriteteve rregullatore kombëtare, projekti synon të ofrojë shërbime ndërkufitare, sjell inovacion teknologjik dhe garanton sigurinë e operimit ndërkufitar; dhe

c) Projekti nuk mund të financohet nga tregu ose nëpërmjet kuadrit rregullator sipas planit të biznesit dhe vlerësimeve të tjera.

3. Projektet me interes për Komunitetin e Energjisë, të realizuara në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 5, pika 7, shkronja “ç”, do të jenë, gjithashtu, të pranueshme për ndihmë financiare të Bashkimit Evropian në formën e granteve për punime kur ato plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni.

Neni 17

Udhëzime për kriteret e dhënies së asistencës financiare të Bashkimit Evropian

Kriteret specifike, të përcaktuara në pikën 2, të nenit 4, dhe parametrat e përcaktuar në pikën 3, të nenit 4, të këtij vendimi, merren parasysh kur përcaktohen kriteret e dhënies së ndihmës teknike e financiare të Bashkimit Evropian nga IPA-ja dhe NDICI-ja.

KREU VIII DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 18

Raportimi dhe vlerësimi

Autoriteti kompetent kombëtar bashkëpunon me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për

raportimin mbi zbatimin e projekteve në listën e Komunitetit të Energjisë, duke ofruar një vlerësim, ndër të tjera, të: progresit të arritur në planifikimin, zhvillimin, ndërtimin e komisionimin e projekteve dhe vonesave përkatëse; fondeve të angazhuara e të disbursuara nga Bashkimi Evropian; progresit në integrimin e burimeve të rinovueshme dhe uljen e emetimeve; evolucionit të nivelit të ndërlikohjes ndërmjet palëve kontraktuese; procesit të dhënies së lejeve dhe pjesëmarrjes publike; si dhe trajtimit rregullator.

Neni 19

Periudha kalimtare për asetet e hidrogjenit

Gjatë një periudhe kalimtare që përfundon më 31 dhjetor 2029, asetet e dedikuara për hidrogjen, të rikontuara nga asetet ekzistuese të gazit natyror, që bëjnë pjesë në kategorinë 3 të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi, mund të përdoren për transportin ose depozitimin e një përzierjeje të paracaktuar të hidrogjenit me gaz natyror ose biometan. Gjatë kësaj periudhe, promovuesit e projekteve bashkëpunojnë ngushtësisht për projektimin dhe zbatimin, me qëllim garantimin e ndërveprueshmërisë së rrjeteve fqinje. Promovuesi ofron prova të mjaftueshme se deri në fund të periudhës kalimtare asetet do të pushojnë së qeni asete gazi natyror dhe do të bëhen asete të dedikuara për hidrogjen. Kualifikimi i këtyre projekteve për ndihmë financiare të Bashkimit Evropian përfundon më 31 dhjetor 2027.

Neni 20

Shfuqizime

Vendimi nr. 685, datë 14.11.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e praktikave për promovimin e investimeve të përbashkëta, rajonale, në infrastrukturën e sektorit të energjisë”, shfuqizohet.

Neni 21

Dispozita përfundimtare

1. Kreu III i këtij vendimi nuk zbatohet për projektet me interes për Komunitetin e Energjisë dhe projektet me interes të ndërsjellë, që kanë hyrë në procesin e dhënies së lejeve dhe për të cilat



promovuesi ka dorëzuar një dosje aplikimi në institucionet përgjegjëse para datës 16 tetor 2016.

2. Për projektet me interes për Komunitetin e Energjisë ose projektet me interes të ndërsjellë, të cilat financohen ose bashkëfinancohen nga fondet e buxhetit të shtetit, hua, grante ose forma të tjera të financimit publik, të cilat krijojnë detyrime të drejtpërdrejta ose të kushtëzuara për financat publike, zbatohen dispozitat dhe procedurat e përcaktuara në vendimin nr. 887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, të ndryshuar.

3. Shtojcat I, II, III, IV, V dhe VI i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

4. Ky vendim shfuqizohet me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mjedisit dhe Enti Rregullator i Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi

SHTOJCA I
KORRIDORET, INTERKONEKSIONET
DHE FUSHAT PRIORITARE TË
INFRASTRUKTURËS ENERGETIKE

1. Korridoret prioritare të energjisë elektrike

Interkoneksionet e energjisë elektrike në Komunitetin e Energjisë: Interkoneksionet ndërmjet palëve kontraktuese, në veçanti për të integruar energjinë elektrike nga burimet e rinovueshme, për të përforcuar infrastrukturën e brendshme të rrjetit, për të nxitur integrimin e tregut në rajon dhe për të garantuar zgjatimet e nevojshme në tokë të rrjeteve në det të hapur, si dhe përforsimet e rrjetit të nevojshme për një rrjet transmetimi të përshtatshëm e të besueshëm.

2. Korridoret prioritare të rrjeteve në det të hapur

Rrjetet në det të hapur në Mesdhe: zhvillimi i rrjetit të energjisë elektrike në det të hapur, energjia elektrike e integruar në det të hapur dhe, kur është e përshtatshme, zhvillimi i rrjetit të hidrogjenit dhe ndërlidhësit përkatës në Detin Mesdhe, për të transportuar energji elektrike ose, kur është e përshtatshme, hidrogjen nga burimet e rinovueshme

në det të hapur drejt qendrave të konsumit e të depozitimit ose për të rritur shkëmbimin ndërkufitar. Palët kontraktuese të përfshira: Shqipëria, Mali i Zi dhe Bosnjë e Hercegovina.

3. Interkoneksionet prioritare të hidrogjenit dhe elektrolizuesit në Komunitetin e Energjisë

Interkoneksionet e hidrogjenit: infrastruktura e hidrogjenit dhe rikonvertimi i infrastrukturës së gazit, që mundësojnë shfaqjen e një shtylle kurrizore të integruar të hidrogjenit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, duke lidhur vendet e rajonit dhe duke adresuar nevojat e tyre specifike infrastrukturore për hidrogjen. Palët kontraktuese të përfshira: të gjitha.

Elektrolizuesit: mbështetja e zbatimit të aplikimeve energji-në-gaz, që synojnë reduktimin e gazeve të efektit serrë dhe kontribuojnë në operimin e sigurt, efikas e të besueshëm të sistemit dhe në integrimin inteligjent të sistemit energjetik. Palët kontraktuese të përfshira: të gjitha.

4. Fushat tematike prioritare

Shtirja e rrjeteve inteligjente të energjisë elektrike: marrja përsipër e teknologjive të rrjeteve inteligjente në të gjithë Komunitetin e Energjisë, për të integruar në mënyrë efikase sjelljen dhe veprimet e të gjithë përdoruesve të lidhur në rrjetin elektrik. Palët kontraktuese të përfshira: të gjitha.

Rrjeti ndërkufitar i dioksidit të karbonit: zhvillimi i infrastrukturës për transportin dhe depozitimin e dioksidit të karbonit ndërmjet palëve kontraktuese, të kapur nga instalimet industriale, me qëllim depozitimin e përhershëm gjeologjik. Palët kontraktuese të përfshira: të gjitha.

Rrjetet inteligjente të gazit: marrja përsipër e teknologjive të rrjeteve inteligjente të gazit në të gjithë Komunitetin e Energjisë, për të integruar në mënyrë efikase një shumëllojshmëri burimesh gazi me karbon të ulët dhe të rinovueshëm. Palët kontraktuese të përfshira: të gjitha.

SHTOJCA II
KATEGORITË E INFRASTRUKTURËS
ENERGETIKE

1. Në lidhje me energjinë elektrike:

a) linjat ajrore të transmetimit të tensionit të lartë dhe shumë të lartë, që kalojnë një kufi ose brenda territorit të një pale kontraktuese, përfshirë zonën ekonomike ekskluzive, nëse janë projektuar për tension prej 220 kV ose më shumë, si dhe kabllo të nëntokësore e nënujore të transmetimit, nëse janë



projektuar për tension prej 150 kV ose më shumë. Për palët kontraktuese dhe sistemet e vogla të izoluar me tension më të ulët, këto pragje janë të barabarta me nivelin më të lartë të tensionit në sistemet e tyre;

b) çdo pajisje ose instalim që bën pjesë në kategorinë e shkronjës “a” dhe mundëson transmetimin e energjisë elektrike të rinovueshme në det të hapur nga vendndodhjet e gjenerimit (infrastrukturë për energjinë elektrike të rinovueshme në det të hapur);

c) impiantet e depozitimit të energjisë, në formë individuale ose të grumbulluar, të përdorura për depozitimin e energjisë në baza të përhershme ose të përkohshme, me kusht që të jenë të lidhura drejtpërdrejt me linjat e transmetimit dhe të shpërndarjes, të projektuara për tension prej 110 kV ose më shumë;

ç) çdo pajisje ose instalim thelbësor për sistemet e shkronjave “a”, “b” dhe “c”, për të operuar në mënyrë të sigurt, të rregullt dhe efikase, përfshirë sistemet e mbrojtjes, monitorimit e kontrollit në të gjitha nivelet e tensionit dhe nënstacionet;

d) rrjetet inteligjente të energjisë elektrike: çdo pajisje ose instalim, sistem dhe komponent digjital që integron teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit (TIK), nëpërmjet platformave digjitale operacionale, sistemeve të kontrollit dhe teknologjive të sensorëve, në nivel transmetimi dhe shpërndarjeje të tensionit të mesëm e të lartë, që synojnë një rrjet më efikas e inteligjent, me kusht që të përfshijnë të paktën dy palë kontraktuese me ndikim pozitiv të konsiderueshëm;

dh) çdo pajisje ose instalim që bën pjesë në kategorinë e shkronjës “a” me funksionalitet të dyfishtë: interkoneksion dhe sistem lidhjeje me rrjetin në det të hapur nga vendndodhjet e gjenerimit të rinovueshëm në det të hapur drejt dy ose më shumë palëve kontraktuese, përfshirë zgjatimin në tokë deri tek nënstacioni i parë (rrjete në det të hapur për energjinë e rinovueshme).

2. Në lidhje me rrjetet inteligjente të gazit:

Çdo pajisje ose instalim që synon të mundësojë e të lehtësojë integrimin e një shumëllojshmërie gazrash me karbon të ulët dhe të rinovueshëm, përfshirë biometanin ose hidrogjenin, në rrjetin e gazit: sisteme e komponentë digjitalë që integrojnë TIK, sisteme kontrolli dhe teknologji sensorësh për monitorimin, matjen, kontrollin e cilësisë dhe menaxhimin interaktiv e inteligjent të prodhimit,

transmetimit, shpërndarjes, depozitimit dhe konsumit të gazit, përfshirë pajisjet për mundësimin e rrjedhave të kundërta nga niveli i shpërndarjes në atë të transmetimit.

3. Në lidhje me hidrogjenin:

a) gazsjellësit për transportin, kryesisht në presion të lartë, të hidrogjenit, përfshirë infrastrukturën e rikonvertuar të gazit natyror, që u japin akses përdoruesve të shumtë të rrjetit në baza transparente e jodiskriminuese;

b) impiantet e depozitimit të lidhura me gazsjellësit e hidrogjenit të presionit të lartë të shkronjës “a”;

c) impiantet e pranimit, depozitimit dhe rigazifikimit ose dekompresimit për hidrogjenin e lëngëzuar ose hidrogjenin e integruar në substanca të tjera kimike;

ç) çdo pajisje ose instalim thelbësor për operimin e sigurt, të rregullt e efikas të sistemit të hidrogjenit ose për të mundësuar kapacitet dydrejtimësh, përfshirë stacionet e kompresorëve;

d) çdo pajisje ose instalim që mundëson përdorimin e hidrogjenit ose të lëndëve djegëse me bazë hidrogjeni në sektorin e transportit brenda rrjetit bazë TEN-T. Asetet e shkronjave “a” deri në “ç”, mund të jenë të ndërtuara rishtazi ose të rikonvertuara nga gazi natyror në hidrogjen.

4. Në lidhje me impiantet e elektrolizuesve:

a) elektrolizuesit, që:

i. kanë të paktën 50 mw kapacitet, të ofruar nga një elektrolizues i vetëm ose nga një grup elektrolizuesish që formojnë një projekt të vetëm e të bashkërenduar;

ii. prodhimi i të cilëve përmbush kërkesën për kursim të emetimeve gjatë ciklit të jetës prej 70 % kundrejt një krahasuesi fosil prej 94 g CO₂eq/MJ; dhe

iii. kanë një funksion të lidhur me rrjetin, në veçanti për fleksibilitetin e përgjithshëm të sistemit;

b) pajisjet e lidhura, përfshirë lidhjen me rrjetin nëpërmjet gazsjellësit.

5. Në lidhje me dioksidin e karbonit:

a) gazsjellësit e dedikuar, të ndryshëm nga rrjeti i gazsjellësve në rrjedhën e sipërme, të përdorur për transportin e dioksidit të karbonit nga më shumë se një burim, për qëllim depozitimin e përhershëm gjeologjik;

b) impiantet fikse për lëngëzimin, depozitimin buferik dhe konvertuesit e dioksidit të karbonit në



funksion të transportit të tij të mëtejshëm nëpërmjet gazsjellësve dhe në mënyra të dedikuara transporti;

c) impiantet sipërfaqësore dhe të injektimit të lidhura me infrastrukturën brenda një formacioni gjeologjik, të përdorur për depozitimin e përhershëm gjeologjik të dioksidit të karbonit;

ç) çdo pajisje ose instalim thelbësor për operimin e duhur, të sigurt e efikas të sistemit, përfshirë sistemet e mbrojtjes, monitorimit e kontrollit.

SHTOJCA III

LISTA PARAPRAKE E PROJEKTEVE

1. Rregullat për grupet

1. Për infrastrukturën energjetike që bie në kompetencën e autoriteteve rregullatore kombëtare, secili grup përbëhet nga përfaqësues të palëve kontraktuese, autoriteteve rregullatore kombëtare, OST-ve, si dhe nga Komisioni Evropian, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë, entiteti ECDSO-E dhe ENTSO-E ose ENTSG. Për kategoritë e tjera, secili grup përbëhet nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, përfaqësuesit e palëve kontraktuese dhe promovuesit e projekteve të përfshira.

2. Grupet dhe organet vendimmarrëse të tyre mund të ndahen, të bashkohen ose të mbledhen në konfigurime të ndryshme, sipas nevojës, për të diskutuar çështje të përbashkëta ose specifike.

3. Secili grup organizon punën e vet në përputhje me përpjekjet për bashkëpunim rajonal dhe strukturat ekzistuese të bashkëpunimit rajonal.

4. Secili grup fton promovuesit e projekteve potencialisht të kualifikueshme, si dhe përfaqësues të administratave kombëtare, autoriteteve rregullatore, shoqërisë civile dhe OST-ve, përfshirë nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendet e treta. Vendimi për të ftuar përfaqësues të tillë merret me konsensus.

5. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë publikon, në një platformë të aksesueshme për palët e interesuara, rregullat e brendshme, listën e përditësuar të organizatave anëtare, informacionin mbi progresin, agjendat dhe procesverbalet e mbledhjeve. Diskutimet e organeve vendimmarrëse dhe renditja e projekteve janë konfidenciale. Të gjitha vendimet për funksionimin e grupeve merren me konsensus ndërmjet palëve kontraktuese dhe Sekretariatit.

2. Procesi për hartimin e listave paraprake

1. Promovuesit e projekteve potencialisht të kualifikueshme që dëshirojnë të fitojnë statusin PECEI dorëzojnë te grupi një aplikim që përfshin:

a) një vlerësim të projektit lidhur me kontributin e tij në zbatimin e objektivave të Komunitetit të Energjisë për energjinë e klimën për vitin 2030 dhe objektivit të neutralitetit klimatik për vitin 2050;

b) një tregues të kategorisë përkatëse të shtojcës II;

c) një analizë të plotësisht të kriterëve përkatëse të pikës 9 e në vijim;

ç) për projektet me pjekuri të mjaftueshme, një analizë kosto-përfitim specifike; dhe

d) çdo informacion tjetër përkatës.

2. Të gjithë marrësit sigurojnë konfidencialitetin e informacionit komercial të ndjeshëm.

3. Për projektet që bien në kompetencën e tyre, autoritetet rregullatore kombëtare dhe, sipas nevojës, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë, kontrollojnë zbatimin koherent të kriterëve dhe të metodologjisë kosto-përfitim dhe vlerësojnë rëndësinë ndërkufitare. Për projektet që nuk bien në kompetencën e autoriteteve rregullatore kombëtare, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë vlerëson zbatimin e kriterëve.

4. Grupi shqyrton nëse zbatohet parimi “efikasiteti energjetik i parit” dhe merr parasysh zgjidhje si menaxhimi i kërkesës, zgjidhjet e organizimit të tregut, zbatimi i zgjidhjeve digjitale dhe rinovimi i ndërtesave si zgjidhje prioritare kur ato çmohen më efikase se ndërtimi i infrastrukturës së re.

5. Grupi mbledhet për të shqyrtuar dhe renditur projektet e propozuara mbi bazën e një vlerësimi transparent, duke përdorur kriteret e pikës 9 e në vijim. Listat paraprake i dorëzohen Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë gjashtë muaj para datës së miratimit të listës. Brenda një muaji nga marrja e opinionit të Bordit, organi vendimmarrës i secilit grup miraton listën e vet paraprake përfundimtare.

SHTOJCA IV

RREGULLAT DHE TREGUESIT, NË LIDHJE ME KRITERET PËR PROJEKTET

1. Një projekt me interes për Komunitetin e Energjisë me ndikim të konsiderueshëm ndërkufitar



është një projekt në territorin e një pale kontraktuese që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Për transmetimin e energjisë elektrike, projekti rrit kapacitetin e transferimit të rrejt, ose kapacitetin e disponueshëm për rrjedhat komerciale, në kufirin e asaj pale kontraktuese me një ose disa palë të tjera, të paktën me 500 mw në krahasim me situatën pa komisionim, ose ul izolimin energjetik të sistemeve të paiterkonektuar dhe rrit kapacitetin e transferimit ndërkuftar me të paktën 200 mw;

b) Për depozitimn e energjisë elektrike, projekti ofron të paktën 225 mw kapacitet të instaluar dhe ka kapacitet depozitimi që lejon një gjenerim neto vjetor prej 250 gwh/vit;

c) Për rrjetet inteligjente të energjisë elektrike, projekti është projektuar për pajisje në nivel tensioni të lartë e të mesëm dhe përfshin OST, OST e OSSH, ose OSSH nga të paktën dy palë kontraktuese, duke plotësuar të paktën dy nga kriteret: përfshin 50 000 përdorues; kap një zonë konsumi prej të paktën 300 gwh/vit; të paktën 20 % e konsumit vjen nga burime të ndryshueshme të rinovueshme; ose ul izolimin energjetik;

ç) Për transmetimin e hidrogjenit, projekti mundëson transmetimin ndërkuftar të hidrogjenit ose rrit kapacitetin ekzistues ndërkuftar me të paktën 10 %, dhe demonstroi se është pjesë thelbësore e një rrjeti të planifikuar ndërkuftar të hidrogjenit;

d) Për depozitimn ose impiantet e pranimit të hidrogjenit, projekti synon të furnizojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të paktën dy palë kontraktuese;

dh) Për elektrolizuesit, projekti ofron të paktën 50 mw kapacitet të instaluar dhe sjell përfitime, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të paktën në dy palë kontraktuese;

e) Për transmetimin e energjisë elektrike të rinovueshme në det të hapur, projekti është projektuar për të transferuar energji nga vendndodhjet e gjenerimit në det të hapur me kapacitet të paktën 500 mw;

ë) Për projektet e dioksidit të karbonit, projekti përdoret për transportin dhe, kur është e zbatueshme, depozitimn e dioksidit të karbonit antropogjen me origjinë nga të paktën dy palë kontraktuese.

2. Kriteret specifike të pikës 10 të vendimit vlerësohen sipas treguesve të mëposhtëm, sipas kategorisë përkatëse:

2.1 Për energjinë elektrike (transmetim, shpërndarje, depozitim): transmetimi i gjenerimit të rinovueshëm drejt qendrave të konsumit; integrimi i tregut, konkurrenca dhe fleksibiliteti i sistemit (përfshirë kontributin në objektivin minimal 15 % të ndërlidhjes); dhe siguria e furnizimit, ndërveprueshmëria dhe operimi i sigurt i sistemit.

2.2 Për rrjetet inteligjente të energjisë elektrike: niveli i qëndrueshmërisë; siguria e furnizimit; integrimi i tregut; dhe siguria e rrjetit, fleksibiliteti e cilësia e furnizimit.

2.3 Për hidrogjenin: qëndrueshmëria; integrimi i tregut dhe ndërveprueshmëria; siguria e furnizimit e fleksibiliteti; dhe konkurrenca.

2.4 Për rrjetet inteligjente të gazit: niveli i qëndrueshmërisë; cilësia e siguria e furnizimit; dhe mundësia i shërbimeve të fleksibilitetit nëpërmjet integritit inteligjent të sektorit.

2.5 Për elektrolizuesit: qëndrueshmëria; siguria e furnizimit; dhe mundësia i shërbimeve të fleksibilitetit.

2.6 Për dioksidin e karbonit: qëndrueshmëria; qëndrueshmëria dhe siguria; dhe zbutja e barrës e rrezikut mjedisor nëpërmjet neutralizimit të përhershëm të dioksidit të karbonit.

SHTOJCA V ANALIZA KOSTO-PËRFITIM NË NIVEL SISTEMI ENERGETIK

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë merr parasysh metodologjitë për analizat kosto-përfitim të zhvilluara nga ENTSO-E dhe ENTSO-G dhe zhvillon metodologji të njëtrajtshme për të gjitha kategoritë e infrastrukturës, të cilat trajtojnë kostot në kuptimin e gjerë, përfshirë aspektet e jashtme, në përputhje me objektivat e Komunitetit të Energjisë për vitin 2030 dhe objektivin e neutralitetit klimatik për vitin 2050, dhe që përmbushin, ndër të tjera, parimet e mëposhtme:

a) Zona e analizës mbulon të gjitha palët kontraktuese në territorin e të cilave ndodhet projekti dhe të gjitha palët kontraktuese fqinje ku projekti ka ndikim të konsiderueshëm;

b) Çdo analizë përfshin analiza ndjeshmërie mbi grupin e të dhënave hyrëse, përfshirë koston e gjenerimit e të gazeve serrë, zhvillimin e prituri të kërkesës e ofertës dhe disponueshmërinë e depozitimit;



c) Analizat përcaktohen mbi bazën e grupit të të dhënave hyrëse shumësektoriale, duke përcaktuar ndikimin me dhe pa secilin projekt;

ç) Sigurohet identifikimi i palëve kontraktuese në të cilat projekti ka ndikim neto-pozitiv (përfituesit), atyre me ndikim neto-negativ dhe bartësit e kostove;

d) Merren parasysh, të paktën, kostot kapitale, operacionale e të mirëmbajtjes, si dhe kostot e induktuara gjatë ciklit teknik të jetës së projektit, përfshirë kostot e jashtme, dhe përfshihet një metodologji e detyrueshme për llogaritjen e raportit përfitim-ndaj-kostos dhe të vlerës aktuale neto;

dh) Sigurohet që masat e përshtatjes ndaj klimës të vlerësohen dhe të pasqyrojnë koston e emetimeve të gazeve serrë.

SHTOJCA VI UDHËZIMET PËR TRANSPARENCËN DHE PJESËMARRJEN E PUBLIKUT

1. Manuali i procedurave i përmendur në pikën 29 të vendimit përmban të paktën:

a) specifikimet e legjislacionit përkatës mbi të cilin bazohen vendimet dhe opinionet për llojet e ndryshme të projekteve, përfshirë legjislacionin mjedisor;

b) listën e vendimeve dhe opinionëve që duhen marrë;

c) emrat dhe hollësitë e kontaktit të autoritetit kompetent, autoriteteve të tjera dhe palëve kryesore të interesuara;

ç) rrjedhën e punës, që përshkruan çdo fazë, përfshirë një kuadër kohor indikativ;

d) informacionin mbi shtrirjen, strukturën dhe nivelin e detajimit të dokumenteve që duhen dorëzuar me aplikimin, përfshirë një listë kontrolluese;

dh) fazat dhe mënyrat për pjesëmarrjen e publikut;

e) mënyrën në të cilën demonstrrohet marrja parasysh e opinionëve të shprehura në konsultim publik;

ë) në masën e mundshme, përkthimet e përmbajtjes në gjuhët e palëve kontraktuese fqinje.

2. Skema e hollësishme e afateve specifikon të paktën: vendimet dhe opinionet që duhen marrë; autoritetet, palët e interesuara dhe publikun e mundshëm; fazat individuale të procedurës dhe kohëzgjatjen e tyre; momentet kryesore dhe afatet e tyre në funksion të vendimit gjithëpërfshirës; si dhe

burimet e planifikuara dhe nevojat e mundshme shtesë.

3. Pa paragjykuar kërkesat për konsultime publike sipas legjislacionit mjedisor, për të rritur pjesëmarrjen e publikut, zbatohen parimet e mëposhtme:

a) Palët e interesuara të prekura nga projekti, përfshirë autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale, pronarët e tokave dhe qytetarët që jetojnë në afërsi, publiku i gjerë dhe shoqatat e tyre, informohen e konsultohen gjerësisht në fazë të hershme, në mënyrë përfshirëse, të hapur e transparente;

b) Autoritetet kompetente sigurojnë që procedurat e konsultimit publik të grupohen bashkë kurdo që është e mundur; secili konsultim mbulon të gjitha çështjet e rëndësishme për fazën e caktuar;

c) Komentet dhe kundërshtimet janë të pranueshme nga fillimi i konsultimit publik e deri në skadimin e afatit;

ç) Promovuesit sigurojnë që konsultimet të zhvillohen gjatë një periudhe që lejon pjesëmarrje të hapur e përfshirëse.

4. Koncepti për pjesëmarrjen publike përfshin të paktën informacion mbi: palët e interesuara të prekura; masat e parashikuara, përfshirë vendndodhjet e datat e propozuara të takimeve; afatet kohore; dhe burimet njerëzore të dedikuara.

5. Në kuadër të konsultimit publik para dorëzimit të dosjes së aplikimit, palët përkatëse të paktën:

a) publikojnë një broshurë informuese me jo më shumë se 15 faqe, që jep në mënyrë të qartë e koncize një pasqyrë të përshkrimit, qëllimit dhe afateve paraprake, planin kombëtar të zhvillimit të rrjetit, rrugët alternative dhe masat e mundshme zbutëse;

b) publikojnë informacionin në faqen e internetit të projektit, në tabelat e njoftimeve të administratave lokale dhe në të paktën një ose, sipas rastit, dy media lokale; dhe

c) ftojnë me shkrim palët e prekura në takime të dedikuara.

6. Fajja e internetit e projektit publikon të paktën: datën e përditësimit të fundit; përkthimet e përmbajtjes në gjuhët e palëve kontraktuese përkatëse; broshurën informuese të përditësuar; një përmbledhje joteknike të përditësuar rregullisht; planin e zbatimit; fondet e alokuara e të disbursuara nga Bashkimi Evropian; planifikimin e projektit dhe të konsultimeve me publikun; hollësitë e kontaktit



për informacion shtesë; dhe hollësitë e kontaktit për parashtrimin e komenteve e kundërshtimeve.

UDHËZIM

Nr. 16, datë 27.8.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 10.7.2023, “PËR NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË PUNONJËSVE ARSIMORË NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “d”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të urdhrit nr. 578, datë 11.11.2025, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Orjana Osmani”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 14, datë 10.7.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

a) Nën-pika “iii”, e shkronjës “a”, të pikës 2, të kreut II ndryshon, si më poshtë:

“iii. Tri klasa, kur numri i nxënësve është 21–30”;

b) Pas nënpikës “iii”, të shkronjës “a”, të pikës 2, të kreut II shtohet nënpika “iii/1”, me këtë përmbajtje:

“iii/1. Katër klasa, kur numri i nxënësve për klasë është 31–50”;

c) Kudo në pikën 3, të kreut II, togfjalëshi “se 80” zëvendësohet “se 60”;

ç) Në shkronjën “c”, të pikës 4, të kreut II, pas togfjalëshit “mësuesi në shkollat e arsimit special” shtohet togfjalëshi “mësuesi i artit pamor, mësuesi i edukimit muzikor”;

d) Pas shkronjës “c”, të pikës 4, të kreut II shtohet shkronja “c/1”, me këtë përmbajtje:

“c/1. Mësuesi i lëndës Edukim fizik dhe sporte: 21 orë në javë”;

dh) Në pikën 4, të kreut II, pas fjalisë “Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës e plotësojnë normën mësimore javore vetëm me orë të profilit të diplomës që zotërojnë.”, shtohet paragrafi me përmbajtjen si vijon:

“Drejtori/nëndrejtori i shkollës që është i profilit të arsimit fillor mund ta plotësojë ngarkesën mësimore javore edhe me orë mësimore të përcaktuara në kreun V të këtij udhëzimi”;

e) Në shkronjën “f”, të pikës 4, të kreut II, togfjalëshi “me 81” zëvendësohet “me 61”;

ë) Në shkronjën “a”, të pikës 5, të kreut II, togfjalëshi “me 81” zëvendësohet “me 61”;

f) Shkronja “a”, e pikës 2, të kreut III, ndryshon si më poshtë:

“a) Kur numri i nxënësve është më shumë se 60, emërohet një drejtor shkolle”;

g) Pas shkronjës “b”, të pikës 3, të kreut III shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1. Mësuesi i lëndës Edukim fizik dhe sporte: 21 orë në javë”;

gj) Në shkronjën “d”, të pikës 3, të kreut III, togfjalëshi “me 81” zëvendësohet “me 61”;

h) Në shkronjën “a”, të pikës 4, të kreut III, togfjalëshi “me 81” zëvendësohet “me 61”;

i) Shkronja “a”, e pikës 2, të kreut IV ndryshon si më poshtë:

“a) Kur numri i nxënësve është më shumë se 60, emërohet një drejtor shkolle”;

j) Në shkronjën “f”, të pikës 3, të kreut IV, pas togfjalëshit “Dega Balet”, të shtohet togfjalëshi:

“, lëndët: Repertor, Teknikë Djem, Puante Vajza, Balet Modern, Valle Popullore, Duet Klasik”;

k) Shkronjat “g” dhe “h”, të pikës 3, të kreut IV ndryshojnë, si më poshtë:

“g) Drejtori i shkollës me 61–200 nxënës: 6 orë në javë.

h) Drejtori i shkollës me 201–600 nxënës: 4 orë në javë”;

l) Në shkronjën “a”, të pikës 4, të kreut IV, togfjalëshi “me 81” zëvendësohet “me 61”.

ll) Pas shkronjës “a”, të pikës 6, të kreut IV shtohet shkronja “a/1” me këtë përmbajtje:

“a/1) Orët e lëndës Formim Praktik Profesional për specialitetin “Futboll” ndahen në grupe “Lojtarët” dhe “Portierët”. Grupi i lojtarëve formohet me nxënës të të njëjtit nivel arsimor.

Grupi i “Portierëve” formohet me jo më pak se 6 nxënës të të njëjtit nivel arsimor”;

m) Pika 18 e kreut V shfuqizohet;



n) Në kreun V, pas pikës 31, shtohen pikat 32, 33 dhe 34 me përmbajtje si më poshtë:

“32. Kryetarit të ekipit lëndor i ulet norma mësimore me 2 orë në javë.

33. Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë e ka normën mësimore 6–10 orë në javë; mësuesi koordinator i këshillimit të karrierës e ka normën mësimore 8–12 orë në javë.

34. Drejtori ose nëndrejtori i ngarkuar me organizimin dhe monitorimin e programit “Pas shkolle”, të ketë ulje në normën mësimore javore në varësi të numrit të grupeve/klubeve, si më poshtë:

a) 2 orë mësimore në javë, kur institucioni ka deri 4 grupe ose klube;

b) 4 orë mësimore në javë, kur institucioni ka mbi 4 grupe ose klube.”

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
Orjana Osmani

URDHËR
Nr. 459, datë 28.8.2026

**PËR MIRATIMIN E MASAVE PËR
REHABILITIMIN E MJEDISIT TË
DËMTUAR²**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 50, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e masave për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar, që merren nga operatorët përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi, sipas shtojcës 1

² Ky urdhër përaftron pjesërisht Direktivën 2004/35/EC, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 prill 2004, “Për përgjegjësinë mjedisore, në lidhje me parandalimin dhe riparimin e dëmit mjedisor”, e ndryshuar nga Direktiva 2006/21/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 mars 2006, Direktiva 2009/31/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 prill 2009,

bashkëlidhur këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. Në bazë të vlerësimit të dëmit mjedisor, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nëse e vlerëson të nevojshme, kërkon zbatimin e masave të tjera specifike, për sa kohë që ato garantojnë një nivel mbrojtjeje mjedisore të barasvlershëm ose më të lartë dhe janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Masat e parashikuara në këtë urdhër zbatohen në përputhje me aktet nënligjore që përcaktojnë veprimtaritë e rrezikshme për mjedisin dhe me legjislacionin për përgjegjësinë mjedisore.

4. Zbatimi i këtyre masave fillon pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të akteve nënligjore për përgjegjësinë mjedisore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të nenin 50 të ligjit për mbrojtjen e mjedisit.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj

Shtojca 1
MASAT PËR REHABILITIMIN E
MJEDISIT TË DËMTUAR

Kjo shtojcë përcakton një kornizë të përbashkët që ndiqet për përzgjedhjen e masave më të përshtatshme për sigurimin e rehabilitimit të mjedisit të dëmtuar.

Masat për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar përfshijnë çdo veprim ose kombinim veprimesh, përfshirë masat lehtësuese, që synojnë rikuperimin, rehabilitimin ose zëvendësimin e burimeve natyrore të dëmtuara dhe/ose të shërbimeve të cenuara, si dhe sigurimin e një alternative ekuivalente ndaj këtyre burimeve natyrore ose shërbimeve, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 50, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar.

Direktiva 2013/30/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 12 qershor 2013; Rregullorja (BE) 2019/1010 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 qershor 2019 dhe e korrigjuar nga Corrigendum.



Rikuperimi, përfshirë rikuperimin natyror, konsiston, në rastin e dëmit ndaj ujërave, llojeve të mbrojtura, habitateve natyrore, përfshirë pyjet, në kthimin e burimeve natyrore të dëmtuara dhe/ose të shërbimeve të cenuara në gjendjen bazë, ndërsa, në rastin e dëmit ndaj tokës, në eliminimin e çdo rreziku të konsiderueshëm që mund të ndikojë negativisht në shëndetin e njeriut.

1. Rehabilitimi i mjedisit të dëmtuar në ujëra ose në lloje të mbrojtura apo habitate natyrore

Rehabilitimi i mjedisit të dëmtuar, në lidhje me ujërat, llojet e mbrojtura apo habitatet natyrore, përfshirë pyjet, realizohet përmes rikthimit të mjedisit në gjendjen bazë, nëpërmjet masave rehabilituese parësore, plotësuese dhe kompensuese, ku:

a) “Rehabilitim parësor” është çdo masë rehabilituese që rikthen burimet natyrore dhe/ose shërbimet e dëmtuara në gjendjen e mëparshme ose sa më afër saj;

b) “Rehabilitim plotësues” është çdo masë rehabilituese e ndërmarrë në lidhje me burimet natyrore dhe/ose shërbimet për të kompensuar faktin që rehabilitimi parësor nuk çon në rikthimin e plotë të burimeve natyrore dhe/ose shërbimeve të dëmtuara;

c) “Rehabilitim kompensues” është çdo veprim i ndërmarrë për të kompensuar humbjet e përkohshme të burimeve natyrore dhe/ose shërbimeve që ndodhin nga data e shkakut të dëmit deri në momentin kur rehabilitimi parësor të arrijë efektin e tij të plotë;

d) “Humbje të përkohshme” janë humbjet që rrjedhin nga fakti që burimet natyrore dhe/ose shërbimet e dëmtuara nuk janë në gjendje të kryejnë funksionet e tyre ekologjike ose të ofrojnë shërbime për burime të tjera natyrore, ose për publikun deri në momentin kur masat parësore ose plotësuese kanë dhënë efekt. Këto nuk përbëjnë kompensim financiar për publikun.

Kur rehabilitimi parësor nuk çon në rikthimin e mjedisit në gjendjen e mëparshme, ndërmerren masa rehabilituese plotësuese. Përveç kësaj, ndërmerren masa rehabilituese kompensuese për të kompensuar humbjet e përkohshme.

Rehabilitimi i mjedisit të dëmtuar, në lidhje me ujërat ose llojet e mbrojtura apo habitatet natyrore përfshirë pyjet, nënkupton, gjithashtu, eliminimin e çdo rreziku të konsiderueshëm për shëndetin e njeriut.

1.1 Objektivat e rehabilitimit

1.1.1 Rehabilitimi parësor është rikthimi i burimeve natyrore dhe/ose shërbimeve të dëmtuara në gjendjen e mëparshme ose sa më afër saj. Si burime natyrore merren në konsideratë llojet e mbrojtura, habitatet natyrore, pyjet, ujërat dhe toka. Këto masa janë masa që zbatohen gjithmonë të parat dhe synojnë rikthimin e strukturës dhe funksionit ekologjik, si më poshtë:

a) Për biodiversitetin:

i. ripyllëzim dhe restaurim i vegjetacionit me specie autoktone;

ii. rivendosje e habitateve natyrore (p.sh.: ligatina, dune, livadhe);

iii. rikthim i strukturës së tokës, mikrohabitateve dhe funksioneve ekologjike;

iv. ripopullim i faunës me specie vendase, kur është ekologjikisht i justifikuar;

v. heqje e specieve invazive dhe rehabilitim i zonës pas ndërhyrjes.

b) Për ujërat:

i. pastrim i trupave ujorë nga ndotësit dhe mbetjet;

ii. rivendosje e shtratit natyror dhe e morfologjisë së lumenjve;

iii. rikthim i regjimit natyror hidrologjik;

iv. riparim dhe rikthim i habitateve ujore.

c) Për tokën:

i. heqje dhe trajtim i tokës së ndotur;

ii. dekontaminim *in situ*, sipas natyrës së ndotjes;

iii. stabilizim fizik/kimik i ndotjes;

iv. rikthim i funksioneve ekologjike të tokës.

1.1.2 Objektivi i rehabilitimit plotësues është të sigurojë një nivel të ngjashëm burimesh natyrore dhe/ose shërbimesh, përfshirë, sipas rastit edhe në një vend alternativ, sikur vendi i dëmtuar të ishte rikthyer në gjendjen e mëparshme. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, vendi alternativ duhet të jetë i lidhur gjeografikisht me vendin e dëmtuar, duke marrë parasysh interesat e popullsisë së prekur. Këto masa synojnë sigurimin e burimeve ose shërbimeve mjedisore të barasvlershme, në vendin e dëmtuar dhe/ose në zona alternative ekologjike të krahasueshme, si më poshtë:

a) Për biodiversitetin:

i. krijim i habitateve të reja ekuivalente në zona të tjera;

ii. përmirësim funksional i habitateve ekzistuese;

iii. zgjerim i sipërfaqeve të mbrojtura;

iv. korridore ekologjike për lidhjen e popullatave.



b) Për ujërat:

- i. krijim i ligatinave kompensuese;
- ii. restaurim i një trupi tjetër ujqor me funksion ekologjik ekuivalent;
- iii. përmirësim i statusit ekologjik të një segmenti tjetër ujqor.

c) Për tokën:

i. rikuperim ekologjik i tokave të degraduara në zona të tjera;

ii. rehabilitim i habitateve dhe tokave me funksion mjedisor ekuivalent.

1.1.3 Rehabilitimi kompensues synon kompensimin e humbjes së përkohshme të burimeve natyrore dhe/ose shërbimeve mjedisore gjatë periudhës nga shkaktimi i dëmit deri në rikthimin e plotë të tyre. Këto masa nuk përbëjnë dëmshpërblim apo kompensim financiar, nuk zëvendësojnë masat parësore apo plotësuese dhe zbatohen paralelisht me to, si më poshtë:

a) Për biodiversitetin:

- i. krijimi i habitateve të përkohshme;
- ii. rritja e nivelit të mbrojtjes së popullatave ekzistuese;
- iii. përmirësim i shërbimeve mjedisore gjatë periudhës tranzitore.

b) Për ujërat:

- i. shtimi i burimeve ujore alternative;
- ii. përmirësimi i përkohshëm i cilësisë ekologjike të trupave të tjerë ujqorë;
- iii. masa për ruajtjen e biodiversitetit ujqor gjatë periudhës tranzitore.

c) Për tokën:

- i. krijimi i funksioneve ekologjike të përkohshme;
- ii. përmirësimi i shërbimeve ekosistimore alternative.

1.1.4 Masa emergjente për eliminimin e kërcënimit të menjëhershëm synojnë parandalimin, kufizimin ose eliminimin e një kërcënimi të menjëhershëm për dëmtim mjedisor dhe zbatohen pa vonesë, para ose pavarësisht masave të rehabilitimit, si më poshtë:

a) Masa teknike dhe operative:

- i. ndërprerja e menjëhershme e aktivitetit që shkakton ose rrezikon të shkaktojë dëmtim mjedisor;
- ii. izolimi dhe stabilizimi i burimit të ndotjes;
- iii. ndalimi i shkarkimeve, rrjedhjeve ose përhapjes së ndotësve;
- iv. vendosja e barrierave fizike ose teknike mbrojtëse;

v. grumbullimi, neutralizimi ose largimi i substancave të rrezikshme;

vi. heqja e materialeve të rrezikshme;

vii. stabilizimi emergjent i zonës së dëmtuar.

1.1.5 Masa administrative:

a) Urdhërim i masave të përkohshme;

b) Kufizim i aksesit publik;

c) Monitorim intensiv emergjent.

1.2 Identifikimi i masave rehabilituese

1.2.1 Për identifikimin e masave rehabilituese parësore duhet të merren në konsideratë opsione që përfaqësojnë veprime për rikthimin e drejtpërdrejtë të burimeve natyrore dhe shërbimeve në gjendjen e mëparshme, në një afat kohor të përshpejtuar ose përmes rehabilitimit natyror.

1.2.2 Për identifikimin dhe përcaktimin e shkallës së masave rehabilituese plotësuese dhe kompensuese, merren në konsideratë qasjet e ekuivalencës burim me burim ose shërbim me shërbim. Sipas këtyre qasjeve, së pari merren në konsideratë shërbimet që ofrojnë burime natyrore apo shërbime të të njëjtë lloj, të së njëjtës cilësi dhe sasi si ato të dëmtuara. Kur kjo nuk është e mundur, sigurohen burime natyrore dhe/ose shërbime alternative. Për shembull, një ulje e cilësisë mund të kompensohet me rritje të sasisë së masave rehabilituese.

1.2.3 Kur nuk është e mundur të përdoren qasjet e para të bazuara në ekuivalencën burim me burim ose shërbim me shërbim, atëherë përdoren teknika alternative të vlerësimit. Autoriteti kompetent mund të përcaktojë metodën e vlerësimit, për shembull vlerësimin monetar, për të përcaktuar shkallën e masave plotësuese dhe kompensuese të nevojshme për riparimin e dëmit. Nëse vlerësimi i burimeve natyrore dhe/ose i shërbimeve të humbura është i realizueshëm, por që vlerësohet se zëvendësimi i burimeve natyrore dhe/ose i shërbimeve nuk mund të kryhet brenda një afati të arsyeshëm kohor ose me një kosto të arsyeshme, atëherë autoriteti kompetent mund të zgjedhë masa riparuese, kostoja e të cilave është e barasvlershme me vlerën monetare të vlerësuar të burimeve natyrore dhe/ose shërbimeve të humbura.

1.2.4 Masat rehabilituese plotësuese dhe kompensuese duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë burime natyrore dhe/ose shërbime shtesë, duke reflektuar preferencat kohore dhe profilin kohor të masave rehabilituese. Për shembull, sa më e gjatë të jetë periudha deri në



arritjen e gjendjes së mëparshme, aq më i madh duhet të jetë niveli i masave rehabilituese kompensuese (në kushte të barabarta).

1.3 Zgjedhja e opsioneve rehabilituese

1.3.1 Opsionet e arsyeshme rehabilituese vlerësohen, duke përdorur teknologjitë më të mira të disponueshme, mbi bazën e kriterëve të mëposhtme:

- i. ndikimi i çdo opsioni në shëndetin dhe sigurinë publike;
- ii. kostoja e zbatimit të opsionit;
- iii. mundësia e suksesit të çdo opsioni;
- iv. shkalla në të cilën çdo opsion parandalon dëmet e ardhshme dhe shmang dëmet dytësore si rezultat i zbatimit të tij;
- v. shkalla në të cilën çdo opsion përfiton secilin komponent të burimit natyror dhe/ose shërbimit;
- vi. shkalla në të cilën çdo opsion merr në konsideratë shqetësimet përkatëse sociale, ekonomike dhe kulturore, si dhe faktorë të tjerë përkatës specifikë për zonën;
- vii. koha e nevojshme që rehabilitimi i mjedisit të dëmtuar të jetë efektiv;
- viii. shkalla në të cilën çdo opsion arrin rikthimin e vendndodhjes së dëmit mjedisor;
- ix. lidhja gjeografike me vendin e dëmtuar.

1.3.2 Gjatë vlerësimit të opsioneve të ndryshme rehabilituese të identifikuar, mund të zgjidhen masa rehabilituese parësore që nuk e rikthejnë plotësisht ujin, llojet e mbrojtura, habitatin natyror, përfshirë pyjet në gjendjen e mëparshme ose që e rikthejnë atë më ngadalë. Ky vendim mund të merret vetëm nëse burimet natyrore dhe/ose shërbimet e humbura në vendin parësor, si rezultat i këtij vendimi, kompensohen përmes rritjes së masave plotësuese ose kompensuese për të siguruar një nivel të ngjashëm burimesh natyrore dhe/ose shërbimesh si ato të humbura. Kjo ndodh, për shembull, kur burime dhe/ose shërbime natyrore ekuivalente mund të sigurohen diku tjetër me kosto më të ulët. Këto masa shtesë rehabilituese përcaktohen në përputhje me rregullat e përcaktuara në pikën 1.2.2 më lart.

1.3.3 Pavarësisht rregullave të përcaktuara në pikën 1.3.2 më sipër dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka të drejtë të vendosë që të mos merren masa të mëtejshme rehabilituese, nëse:

- a) masat rehabilituese të marra tashmë sigurojnë që nuk ekziston më asnjë rrezik i rëndësishëm për

ndikim negativ në shëndetin e njeriut, në ujëra ose në lloje të mbrojtura dhe në habitate natyrore; dhe

b) kostoja e masave rehabilituese që do të duheshin marrë për të arritur gjendjen e mëparshme ose një nivel të ngjashëm do të ishte joproporcionale në raport me përfitimet mjedisore që do të arriheshin.

2. Rehabilitimi i dëmit në tokë

2.1 Masat e nevojshme për rehabilitimin e tokës së ndotur merren për të siguruar, të paktën, që ndotësit përkatës të hiqen, të kontrollohen, të kufizohen ose të reduktohen, në mënyrë që toka e ndotur, duke marrë parasysh përdorimin e saj aktual ose përdorimin e miratuar në të ardhmen në kohën e shkaktimit të dëmit, të mos përbëjë asnjë rrezik të konsiderueshëm me ndikim negativ të pakthyeshëm në shëndetin e njeriut.

2.2 Prania e këtyre rreziqeve vlerësohet përmes procedurave të vlerësimit të rrezikut, duke marrë parasysh karakteristikat dhe funksionin e tokës, llojin dhe përqendrimin e substancave të dëmshme, përgatitjeve, organizmave ose mikroorganizmave, rrezikun e tyre dhe mundësinë e përhapjes së tyre.

2.3 Përdorimi përcaktohet mbi bazën e rregullave për përdorimin e tokës ose rregullave të tjera përkatëse, në fuqi, nëse ka, në kohën kur ka ndodhur dëmi.

2.4 Nëse përdorimi i tokës ndryshohet, merren të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar çdo ndikim negativ në shëndetin e njeriut.

2.5 Nëse mungojnë rregullat për përdorimin e tokës ose rregulla të tjera përkatëse, natyra e zonës përkatëse ku ka ndodhur dëmi, duke marrë parasysh zhvillimin e pritshëm të saj, përcakton përdorimin e zonës specifike.

2.6 Duhet të merret në konsideratë edhe opsioni i rehabilitimit natyror, pra një opsion në të cilin nuk ndërmerret asnjë ndërhyrje e drejtpërdrejtë njerëzore në procesin e rehabilitimit.

**URDHËR****Nr. 460, datë 28.8.2026****PËR MIRATIMIN E METODËS, PËR SPECIFIKIMIN E SHPENZIMEVE, PËR PËRCAKTIMIN DHE ELIMINIMIN E KËRCËNIMIT DHE TË DËMIT NË MJEDIS**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “b”, të pikës 4, të nenit 50, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Metodës për specifikimin e shpenzimeve për përcaktimin dhe eliminimin e kërcënimit dhe të dëmit në mjedis”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Zbatimi i kësaj metode fillon pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të akteve nënligjore për përgjegjësinë mjedisore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të nenin 50 të ligjit për mbrojtjen e mjedisit.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Kombëtare e Mjedisit, si autoritet kompetent sipas legjislacionit për përgjegjësinë mjedisore dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Mjedisit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT**Sofjan Jaupaj****METODA PËR SPECIFIKIMIN E SHPENZIMEVE PËR PËRCAKTIMIN DHE ELIMINIMIN E KËRCËNIMIT DHE TË DËMIT NË MJEDIS**

1. Metoda përcakton rregullat dhe kriteret për përcaktimin, vlerësimin, dokumentimin e shpenzimeve dhe kostove, që lidhen me:

- a) identifikimin dhe vlerësimin e kërcënimeve të menjëhershme të dëmit në mjedis;
- b) zbatimin e masave parandaluese;
- c) projektimin dhe zbatimin e masave riparuese parësore, plotësuese dhe kompensuese;

ç) monitorimin dhe aktivitetet administrative;

d) rikuperimin e kostove nga operatorët përgjegjës.

2. Kjo metodë synon:

- a) zbatimin efektiv të parimit “ndotësi paguan”;
- b) garantimin e transparencës, proporcionalitetit dhe objektivitetit në vlerësimin e kostove;
- c) harmonizimin e praktikës administrative me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e mjedisit dhe kuadrin e përgjegjësisë mjedisore.

3. Metoda zbatohet për rastet e kërcënimeve të menjëhershme të dëmit në mjedis dhe rastet e dëmit mjedisor, që prekin:

- a) speciet e mbrojtura, habitatet natyrore dhe ekosistemet, përfshirë funksionet dhe shërbimet e tyre ekologjike, në masën që mbulohen nga përkufizimi i dëmit mjedisor sipas legjislacionit në fuqi;
- b) ujërat;
- c) tokën.

4. Dëmi i shkaktuar nga ndotësit ose elementet e transportuara nëpërmjet ajrit përfshihet në fushën e zbatimit të kësaj metode, për aq sa këta shkaktojnë dëm ndaj ujërave, tokës, specieve të mbrojtura ose habitateve natyrore, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Kur dëmi prek një zonë të mbrojtur, një zonë kandidate ose të miratuar të rrjetit Emerald, një zonë të propozuar për rrjetin Natura 2000 ose një korridor ekologjik, vlerësimi merr në konsideratë objektivat e ruajtjes, planin e menaxhimit, formularët standardë të të dhënave, integritetin ekologjik dhe rolin funksional të zonës në rrjetin ekologjik.

6. Parashikimet e kësaj metode zbatohen ndaj operatorëve që ushtrojnë veprimtari profesionale të konsideruara me rrezik për mjedisin, si dhe ndaj operatorëve të tjerë përgjegjës për dëmtimin e specieve të mbrojtura dhe habitateve natyrore, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Kjo metodë nuk prek:

- a) regjimet e përgjegjësisë civile të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;
- b) përgjegjësinë penale;
- c) masat administrative dhe gjobot që nuk lidhen me rikuperimin e kostove, sipas legjislacionit për përgjegjësinë mjedisore;
- d) detyrimet financiare dhe garancitë sektoriale të parashikuara nga legjislacioni sektorial në fuqi.

8. Për qëllimet e kësaj metode:



a) “kosto” është çdo shpenzim i arsyeshëm dhe i nevojshëm i kryer për identifikimin, vlerësimin, parandalimin, kontrollin, monitorimin dhe riparimin e dëmit mjedisor;

b) “dëm mjedisor”, “kërcënim i menjëhershëm për dëm në mjedis”, “masa parandaluese”, “masa riparuese”, “gjendje bazë” dhe “autoritet kompetent” kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

9. Përcaktimi i kostove mbështetet në parimet:

- a) “ndotësi pagan”;
- b) proporcionalitetit;
- c) transparencës;
- ç) objektivitetit dhe verifikueshmërisë;
- d) përdorimit të informacionit më të mirë shkencor dhe teknik të disponueshëm.

10. Kostot e identifikimit përfshijnë shpenzimet e nevojshme për përcaktimin e ekzistencës së dëmit ose kërcënimit mjedisor, natyrës dhe shkallës së ndikimit, si dhe identifikimin e operatorit përgjegjës. Kostot e identifikimit mund të përfshijnë, gjithashtu, vizitat paraprake në terren, mbledhjen e të dhënave, hartëzimin, analizat gjeohapësinore dhe përgatitjen e informacionit bazë të nevojshëm për vlerësimin e dëmit ose kërcënimit mjedisor.

11. Kostot e hetimit llogariten mbi bazën e shpenzimeve faktike të dokumentuara për shërbimet e kontraktuara, kostove standarde për marrjen e mostrave dhe analizat laboratorike, si dhe kostove të arsyeshme të personelit dhe të udhëtimit të autoriteteve kompetente, dhe përfshijnë:

- a) inspektimet në terren;
- b) marrjen e mostrave;
- c) analizat laboratorike;
- ç) studimet teknike dhe shkencore;
- d) modelimin e përhapjes së ndotësve.

12. Shpenzimet për ekspertë, laboratorë të akredituar, institucione kërkimore dhe ofrues të specializuar shërbimesh konsiderohen kosto të rikuperueshme kur janë të nevojshme për vlerësimin e dëmit, përzgjedhjen e masave riparuese ose monitorimin e tyre. Tarifat për ekspertët, laboratorët dhe ofruesit e tjerë të specializuar konsiderohen të arsyeshme kur përcaktohen nëpërmjet procedurave konkurruese ose bazohen në tarifa standarde të njohura nga autoritetet publike kompetente.

13. Kur ekziston rrezik për shëndetin e njeriut, habitatet natyrore, speciet e mbrojtura, ujërat ose tokën, kostot e analizës së rrezikut përfshijnë:

- a) vlerësimin e rrezikut për shëndetin e njeriut;
- b) vlerësimin e rrezikut ekologjik;
- c) analizat socio-ekonomike;
- ç) analizat kosto-përfitim dhe kosto-efektivitet;
- d) numrin, dendësinë dhe shtrirjen e popullatës së prekur;
- dh) rolin e individëve ose sipërfaqes së prekur në ruajtjen e species apo habitatit;
- e) rrallësinë dhe shkallën e kërcënimit;
- ë) sipërfaqen e habitatit të dëmtuar;
- f) funksionet ekologjike dhe lidhshmërinë e habitatit;
- g) kapacitetin për rigjenerim natyror;
- gj) ndikimin mbi statusin e ruajtjes;
- h) kohëzgjatjen, kthyeshmërinë dhe efektet kumulative të dëmit.

14. Kostot e masave parandaluese përfshijnë çdo shpenzim të nevojshëm për parandalimin, kufizimin ose minimizimin e një kërcënimi të menjëhershëm të dëmit në mjedis.

15. Kur nevojitet ndërhyrje e menjëhershme për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ose të mjedisit, të gjitha kostot e arsyeshme dhe të nevojshme të masave emergjente konsiderohen kosto të rikuperueshme.

16. Kostot e riparimit parësor përfshijnë shpenzimet e nevojshme për rikthimin e burimeve natyrore dhe shërbimeve të ekosistemit në gjendjen bazë ose sa më afër saj. Autoriteti kompetent dokumenton arsyet e urgjencës, alternativat e shqyrtuara, masat e zbatuara dhe kostot përkatëse.

17. Kur riparimi parësor nuk siguron rikthimin e plotë të gjendjes bazë, autoriteti kompetent përcakton masat plotësuese dhe kostot përkatëse sipas metodave të njohura të ekuivalencës.

18. Kostot e riparimit kompensues përfshijnë shpenzimet për kompensimin e humbjeve të përkohshme të burimeve natyrore dhe shërbimeve të ekosistemit deri në rikuperimin e plotë. Humbjet e përkohshme llogariten për periudhën nga data e shkakimit të dëmit deri në rikthimin e plotë të burimeve natyrore dhe shërbimeve të ekosistemit. Vlerësimi merr në konsideratë nivelin dhe kohëzgjatjen e humbjes, trajektoren e rikuperimit dhe, kur është e përshtatshme, përdorimin e një norme të arsyetuar skontimi.



19. Kur rikuperimi natyror përzgjidhet si opsioni më i përshtatshëm, kostot e rikuperueshme përfshijnë monitorimin, vlerësimin dhe masat e menaxhimit, të nevojshme për sigurimin e procesit të rimëkëmbjes. Kur rikuperimi natyror përzgjidhet si opsioni më i përshtatshëm, autoriteti kompetent dokumenton arsyetimin teknik të përzgjedhjes, afatin e pritshëm të rikuperimit dhe masat alternative që do të merren në rast se rikuperimi nuk zhvillohet sipas parashikimeve.

20. Kostot e monitorimit përfshijnë shpenzimet për verifikimin e efektivitetit të masave parandaluese dhe riparuese, monitorimin e rikuperimit dhe raportimin e rezultateve.

21. Kostot administrative përfshijnë shpenzimet e autoriteteve kompetente për inspektime, procedura administrative, koordinim institucional dhe vendimmarrje në kuadër të përgjegjësisë mjedisore.

22. Kostot ligjore dhe gjyqësore të lidhura drejtpërdrejt me zbatimin e përgjegjësisë mjedisore janë të rikuperueshme sipas legjislationit në fuqi.

23. Kostot përcaktohen, mbi bazën e:

- a) shpenzimeve faktike të dokumentuara;
- b) çmimeve të tregut;
- c) vlerësimeve të ekspertëve;
- ç) normave standarde të kostos, të miratuara sipas akteve përkatëse nënligjore.

Kur kostot faktike nuk mund të përcaktohen ose dokumentohen plotësisht, autoriteti kompetent mund të përdorë vlerësime të arsyetuara, kosto referuese për njësi ose modele standarde të kostove për skenarë tipikë të parandalimit dhe riparimit.

24. Për vlerësimin e humbjeve mjedisore mund të përdoren:

- a) metoda e ekuivalencës burim-me-burim;
- b) metoda e ekuivalencës shërbim-me-shërbim;
- c) metoda e kostos së zëvendësimit;
- ç) metoda e kostos së restaurimit;
- d) metoda të tjera të njohura në praktikën e Bashkimit Evropian.

Autoriteti kompetent përzgjedh metodën më të përshtatshme bazuar në karakteristikat e dëmit dhe disponueshmërinë e të dhënave.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 3814, datë 8.7.2026, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Aleksandra Trola, e datëlindjes 29.12.1962, dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë e kërkuarit, z. Agron Trola.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 3815, datë 8.7.2026, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Mejtime Xhuveli, e datëlindjes 5.7.1943, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë, dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë e kërkuarës znj. Aelita Mani.



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË[Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 190|Datë: 01.09.2026 13:26:43
+02:00|ccda65cb-5cc5-45e5-8a5e-90ddd6d7df27

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)